

1 E hënë, 2 tetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 9.34

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi. Mirë se erdhët.

7 Sekretare e Gjykatës, paraqisni lëndën, ju lutem.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është
9 çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër
10 Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Të shohim kush është i pranishëm në sallën e gjyqit.

14 Fillojmë me Prokurorinë.

15 Z. Prokuror, fjala është për ju.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Për ZPS-në është
17 Line Pedersen, Federica Genovesi, Gaia Pergolo dhe Filippo de
18 Minicis, që jam unë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Mbrojtësi i Viktimave?

22 Z. LAWS: [Përkthim] Unë jam Simon Laws, Përfaqësuesi i
23 Viktimave dhe kam bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim].

25 Mbrojtja, fjala është për ju.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Jam unë Jean-Louis
2 Gilissen. Edhe z. Pjetër Shala është këtu. Kemi z. Aouini,
3 znj. Leto Cariolou, bashkëmbrojtësen, Dzeneta Petravica, që
4 është menaxhere e lëndës, Juliette Healy, Judit Kolbe dhe
5 Kailin Chen. Ju faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit.

8 Për procesverbal, z. Shala, na dëgjoni?

9 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj mirë.
10 Faleminderit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot
12 do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit të Mbrojtjes,
13 dëgjojmë dëshminë e z. Bedri Dervishaj. Është dëshmitar i
14 Mbrojtjes.

15 Përpara se të fillojmë me dëshminë ka disa çështje
16 procedurale që do të doja t'i trajtonim. Së pari është një
17 urdhër me gojë sa i takon kërkesës së Mbrojtjes për të
18 përdorur gjatë pyetjeve të Dëshmitarit 02, një material që
19 është nxjerrë rishtazi. Dhe po them dhe numrin për
20 procesverbal që është DPS01566-DPS01568. Janë tre pamje të
21 fotografuara Google të Kukësit. Kërkesën e kemi marrë me postë
22 elektronike më 25 shtator 2023, në orën 15.23 të pasdites.
23 Materiali doli po në të njëjtën ditë, me paketën 163 dhe u
24 shtua në listën e prezantimeve për këtë dëshmitar. Nuk morëm
25 asnjë koment nga Prokuroria dhe nga Mbrojtësi i Viktimave sa i

1 takon kësaj kërkesë. Rrjedhimisht, autorizojmë Mbrojtjen ta
2 përdorë këtë material gjatë pyetjeve të dëshmitarit, sepse
3 është nxjerrë paraprakisht në kohë. Kundërshtime nuk pati nuk
4 pati nga Prokuroria, as nga Mbrojtësi i Viktimave. Të gjithë
5 patën kohë të mjaftueshme për ta analizuar. Dhe do të shërbejë
6 për dëshminë e këtij dëshmitari.

7 Me këtë mbyll urdhrin me gojë.

8 Gjithashtu dua të them për procesverbal një urdhër me
9 gojë që është lëshuar me postë elektronike të hënën, më 25
10 shtator 2023, në orën 16.55 të pasdites, ka qenë një kërkesë e
11 Mbrojtjes për zgjatje afati për dorëzimin e kërkesave për
12 pranimin e dëshmive jогоjore. Është parashtrim i protokolluar
13 00666 i 22 shtatorit 2023.

14 Më konkretisht, kemi konstatuar se kërkesa u udhëzua
15 mjaftueshëm paraprakisht në kohë për t'i dhënë mundësi Trupit
16 Gjykues për të marrë vendim në lidhje me këtë përpara
17 përfundimit të afatit, siç përcaktohet në rregullën 76 të
18 Rregullores së Procedurës dhe Provave dhe Mbrojtja ka
19 paraqitur arsye të vlefshme, siç kërkohet nga rregulla 9(5)(a)
20 e Rregullores, duke marrë parasysh se Mbrojtja shpjegoi se ju
21 desh të merrej me disa afate të tjera urgjente kohët e fundit,
22 ishte duke u përgatitur për seancat e pritshme dhe po
23 përfundonte në të njëjtën kohë edhe veprimtaritë hetimore dhe,
24 gjithashtu, se do të dorëzojë një vëllim të madh dokumentesh
25 për t'u pranuar si prova, nuk mendojmë se i është shkaktuar

1 ndonjë dëmtim Mbrojtësit të Viktimave dhe Prokurorisë në se e
2 miratojmë kërkesën pa u dhënë atyre mundësinë për të shprehur
3 mendimin e tyre, e zbatojmë kërkesën në bazë të rregullës
4 9(5)(a) dhe (6) të Rregullores. Dhe udhëzojmë Mbrojtjen të
5 dorëzojnë kërkesën për pranimin e dëshmimeve jogojore, siç
6 sugjerohet në paragrafin 3 të kërkesës, sipas procedurës.
7 Pritet nga Mbrojtja të dorëzojë dy kërkesa të ndara. E para të
8 dorëzohet të premtën, më 13 tetor 2023 dhe kërkesa e dytë të
9 premtën, më 27 tetor 2023.

10 Me këtë mbyll vendimin me gojë të Trupit Gjykses.

11 Së treti, për procesverbal do të flas për disa udhëzime
12 që i janë dërguar palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave po ashtu
13 më 25 shtator 2023 në orën 12.34 sa i takon përdorimit të
14 materialeve gjatë pyetjeve të dëshmitarëve. Udhëzimet u
15 përcollën nga Trupi Gjykses në vijim të udhëzimeve që janë
16 dhënë më përpara lidhur me këtë aspekt dhe që shprehen në
17 vendimin për zhvillimin e procesit gjyqësor, që është
18 parashtrimi 00434, paragrafët 44 dhe 51.

19 Në këtë udhëzim ne kemi thënë se do të pranojmë
20 kundërshtimet për përdorimin e çdo materiali me postë
21 elektronike, siç specifikohet në paragrafët 47 dhe 49 të këtij
22 vendimi. Megjithatë, përgjigjet dhe kundërpërgjigjet lidhur me
23 kundërshtimet parimisht nuk do të merren përpara se të merren
24 në pyetje një dëshmitar dhe Trupi Gjykses nuk do të marrë
25 asnjë vendim lidhur me kundërshtimet në këtë pikë. Për të

1 pasur një zhvillim eficient të procesit gjyqësor, përgjigjet
2 dhe kundërpërgjigjet do të pranohen me gojë në sallën e gjyqit
3 në momentin që do të paraqitet një material dhe kur pala apo
4 pjesëmarrësi në fjala synon ta përdorë këtë material me
5 dëshmitarin. Trupi Gjykses do të vendosë lidhur me
6 kundërshtimet përpara se të përdoret ky material.

7 Në fund, udhëzojmë palët dhe Mbrojtësin e Viktimave që
8 për dëshmitarët e ardhshëm të numërtojnë materialet të
9 përfshira në listën që do të përdoret për marrjen në pyetje të
10 secilit dëshmitar dhe në listën e prezantimeve të ndjekin të
11 njëjtën radhë që kanë paraqitur në listën e materialeve që
12 donin të përdorni. Pra, të përkojë numrat në mënyrë që të
13 lehtësohet dhe puna e Trupit Gjykses kur të analizojë
14 dokumentet që na jepen.

15 Pra, para se të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit, dua
16 të trajtojë dy çështje praktike. E para lidhur me
17 disponueshmërinë e palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave për
18 seanca shtesë dhe aspekti i dytë lidhet me datat për dëshmitë
19 e pritshme të dy dëshmitarëve të Mbrojtjes.

20 E para. Trupi Gjykses dëshiron të dijë nëse jeni të
21 disponueshëm për seanca shtesë konkretisht më 26 tetor, nga
22 ora 9.00 e paradites deri në 10.30 dhe 11.00 deri në 12.00, që
23 është e enjte. Pra, do kemi dhe seanca tri ditët e para të
24 asaj jave, por të shoh mundësinë për seanca shtesë. Dhe 27
25 tetor nga ora 1.30 e pasdites deri në 2.30 -- më falni dhe

1 njëherë pra, nga ora 1.30 deri 2.30 dhe pastaj 3.00 pa një
2 çerek deri në 16.00.

3 Nëse mund të na informoni deri në pushimin e drekës, nëse
4 mund të na përgjigjeni lidhur me këtë, do na shërbente shumë
5 ose mund të përgjigjeni që tani në fakt.

6 Ja po shoh Prokurorinë. Jeni të disponueshëm?

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, parimisht po. Po ora 12.00
8 është -- më jepni kohë deri në drekë që t'ua konfirmoj
9 përfundimisht.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Po, ne jemi të disponueshëm në
11 periudhën e propozuar.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
13 shoh nga Mbrojtja.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, nuk ka asnjë problem. Dua ta
15 verifikoj sa për siguri po parimisht mund t'ju them që s'ka
16 asnjë problem.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit.

19 Mirë do flasim edhe njëherë për këtë.

20 Sa i takon kërkesës së dytë, a i dini datat saktë për
21 Dëshmitarin 03887, datat e sakta? Dhe Dëshmitarin 4-03. Po
22 flasim për bllokun e nëntë të dëshmimeve, që i bie 20 me 24
23 nëntor 2023, si periudhë kohore. Avokat, a mund të na thoni
24 tani nëse e keni informacionin, nëse nuk e keni tani, sapo të
25 keni mundësi, ju lutem?

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Mirëmëngjes. Për Dëshmitarin 3887,
2 ka konfirmuar se do të jetë i disponueshëm atë javë, javën e
3 20 nëntorit, mund të fillojmë me atë. Fillojmë me atë. Por
4 duhet të na kuptoni që ka dhe aspekte të tjera që mund të
5 ndikojnë, mbase mund të filloj ditën e dytë asaj jave, ditën e
6 tretë të asaj jave. Nuk e themi dot me saktësi se cilën ditë
7 të javës së 20 nëntorit. Mund të filloj të hënë a të martë,
8 nuk ka ndonjë problem parimisht. Megjithatë, presim që atë
9 javë të jetë i disponueshëm për të dhënë dëshminë.

10 Sa i takon Dëshmitarit 03, na ka konfirmuar në fund të
11 javës së shkuar se data 27 nëntor është data që parapëlqen ky
12 dëshmitar, kështu që mund të fillojmë me të javën pasardhëse
13 me të njëjtin bllok, pra, më 27 nëntor nëse është e mundur.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit që për dëshmitarin e parë keni fleksibilitet,
16 është gjë e mirë kjo se na ndihmon dhe ne që të bëjmë
17 planifikimin kjo gjë. Faleminderit.

18 Tani mund të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit.

19 Shoh Prokurorin që është çuar në këmbë.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

21 Nëse është e mundur dua pak sqarime, na nevojiten ca
22 sqarime sa i takon përmbledhjes së dëshmisë për dëshmitarin që
23 na ka dhënë Mbrojtja. Po për këtë duhet të kalojmë në seancë
24 private që të flasim pak më në thellësi.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull.

2 Sekretare, kalojmë në seancë private.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
2 Dëshmitari do ta japë dëshminë pa masa mbrojtëse në sallën e
3 gjyqit. Sidoqoftë, nëse lind nevoja që të kalojmë në seancë
4 private sepse duhet të mbrojmë identitetet e dëshmitarëve të
5 tjerë apo viktimave të tjera, ju lutem, kërkojini Trupit
6 Gjykues këtë gjë.

7 Do të kemi tre seanca e rregullta nga një orë e gjysëm me
8 pushimet e parashikuara si zakonisht dhe mendoj që ne mund të
9 fillojmë tani.

10 Sillni dëshmitarin në sallën e gjyqit, ju lutem.

11 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Uluni. Z. Dervishaj, mirëmëngjes.

14 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
16 se erdhët para Dhomave të Specializuara.

17 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
19 dëgjoni përkthimin?

20 DËSHMITARI: Po, po. Mirë po e dëgjoj.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
22 Shala, ju e dëgjoni dëshmitarin?

23 I AKUZUARI:[Përmes videolidhjes] Po, e ndëgjoj shumë
24 mirë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

1 mirë.

2 Z. Dervishaj, si jeni?

3 DËSHMITARI: Mirë, mirë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
5 fillojmë me dëshminë tuaj sot. Përpara se të fillojmë do t'ju
6 jap disa udhëzime.

7 Jeni thirrur që të jepni dëshmi përpara Dhomave të
8 Specializuara në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar
9 kundër z. Shala për ta ndihmuar Trupin Gjykes që të dalë me
10 një vendim. Së pari do ju kërkojmë të lexoni deklaratën
11 solemne se do të thoni të vërtetën dhe pastaj do t'ju bëjnë
12 pyetje, fillimisht Avokati i Mbrojtës i z. Shala, më pas
13 përfaqësuesit e Zyrës së Prokurorit të Specializuar që janë
14 ulur aty, më pas Avokatët që përfaqësojnë viktimat
15 pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore që janë afër jush dhe
16 në fund, mund t'ju bëjmë pyetje dhe ne, Gjykatësit e Trupit
17 Gjykes dhe ndonjëherë edhe gjatë pyetjeve të palëve ne do
18 ndërhyjmë për të bërë pyetje.

19 Përpara se të lexojmë deklaratën solemne, do t'ju jap
20 disa udhëzime praktike për mënyrën sesi do t'u përgjigjeni
21 pyetjeve.

22 Z. Dervishaj, ju lutem dëgjoni me kujdes çdo pyetje që do
23 ju bëjnë. Nëse nuk e kuptoni, lirisht kërkoni që pyetja të
24 përsëritet. Ne duam të na thoni të vërtetën, të na thoni çfarë
25 keni parë me sytë tuaj, çfarë keni përjetuar, çfarë keni

1 ndjerë dhe çfarë përshtypjesh ju janë krijuar. Nëse nuk keni
2 parë diçka vetë apo nuk keni dëgjuar diçka ju vetë, na thoni
3 nga e keni zbuluar një informacion të caktuar.

4 Mbase nuk do ju kujtohen të gjitha hollësitë e ngjarjeve
5 që kanë ndodhur dhe nuk ka problem. Thjesht na thoni "Nuk më
6 kujtohet", nëse është rasti. Mos hamendësoni, mos krijoni, mos
7 sajoni informacion. Nuk ka asgjë të keqe të thuash që nuk e di
8 një gjë. Ju lutem përgjigjuni pyetjeve që do ju bëjnë. Nëse
9 duam më shumë sqarim bëjmë ne pyetje shtesë. Pra, dua të them
10 përgjigjuni vetëm pyetjes, thelbin.

11 Gjithashtu, dua t'ju kujtoj se keni të drejtë të
12 kundërshtoni, të jepni dëshmi lidhur me aspekte që mund të ju
13 vetëinkriminojnë në përputhje me rregullën 151(1) të
14 Rregullores.

15 Z. Dervishaj, i kuptuat të gjitha këto?

16 DËSHMITARI: Po.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
18 edhe disa udhëzime të tjera të mëtejshme. Çdo gjë që thoni
19 këtu, sikurse keni vënë re, përkthehet dhe regjistrohet.
20 Prandaj është shumë e rëndësishme që të flisni para
21 mikrofonit, të flisni qartë dhe të flisni ngadalë.

22 Po ashtu është shumë e rëndësishme është që të ktheni
23 përgjigje pesë sekonda pasi të është bërë një pyetje, sepse ky
24 pesë sekondëshi i jep mundësi përkthyesve të mbarojnë fjalinë
25 dhe që gjithçka pastaj të pasqyrohet në procesverbal.

1 Nëse unë ngreh dorën, siç po bëj tani, ndaloni së foluri,
2 sepse nëse po flisni dhe flasë dhe unë njëkohësisht dhe të
3 them pushoni flasim njëkohësisht. Dhe nuk duhet të ndodhë kjo
4 gjë sepse është e pamundur për përkthyesit pastaj. Në rregull?

5 Nëse keni pyetje, nëse keni nevojë për pushim, ju duhet
6 ndihmë për diçka, ndrini dorën dhe do ju jap fjalën që të
7 flisni. Ndonjëherë mund t'ju kërkojmë që të dilni nga salla e
8 gjyqit sepse mbase duhet të diskutojmë diçka lidhur me ndonjë
9 nga pyetjet që u është bërë.

10 A i kuptuat të gjitha këto?

11 DËSHMITARI: Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
13 rregull. Mund të ndodhë që t'ju kërkojmë që të bëni ndonjë
14 shënim në dokumentet që ju japim ndonjëherë. Nëse ju kërkojmë
15 që ta bëni këtë, Asistenti që është pranë jush, do ju japë një
16 stilolaps dhe ju do bëni një shënim në kompjuter dhe del dhe
17 në ekranet tona kjo njëherazi. Në rregull?

18 DËSHMITARI: Okej.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Siç
20 bëjmë me çdo dëshmitar, tani do ju kërkojmë të lexoni
21 deklaratën solemne se do thoni të vërtetën dhe, z. Dervishaj,
22 ju kujtoj se është vepër penale në juridiksionin e Dhomave të
23 Specializuara të japësh dëshmi të rremë. E kuptuat?

24 DËSHMITARI: Me lexu me zë?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

1 kuptuat këtë që thamë? Mund ta lexoni me zë, po fillimisht, ju
2 lutem, përgjigjuni pyetjes sime. Pra, e kuptuat që është vepër
3 penale të japësh dëshmi të rremë?

4 DËSHMITARI: Po.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
6 mirë.

7 Tani lexoni me zë të lartë tekstin që ju është vënë
8 përpara.

9 DËSHMITARI: Betimi solemn. I ndërgjegjshëm për rëndësinë
10 e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
11 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
12 vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehur asgjë për të
13 cilën kam dijeni.

14 DËSHMITARI: Bedri Dervishaj

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit, Dëshmitar. Tani jeni nën betim për të thënë të
17 vërtetën dhe mund të fillojmë me pyetjet dhe pyetjet do të
18 fillojnë me Avokatët Mbrojtës të cilëve do ju jap fjalën.

19 Ju lutem, vazhdoni. Avokat, keni parashikuar tre orë për
20 pyetjet tuaja. Nëse ka ndryshime, ju lutem na informoni.

21 Z. AOUIINI: [Përkthim] Faleminderit.

22 Pyetje nga z. Aouini:

23 Z. AOUIINI: [Përkthim]

24 PY. Mirëmëngjes, z. Dervishaj.

25 PË. Mirëmëngjes.

1 PY. Si jeni? Sikurse e dini, unë jam një nga avokatët që
2 përfaqësojmë z. Shala në këtë proces gjyqësor dhe do ju bëjmë
3 disa pyetje gjatë kohës që jeni në sallë e gjyqit. Në rregull?

4 PË. Në rregull.

5 PY. Z. Dëshmitar, ju lutem a mund të na thoni emrin dhe
6 mbiemrin?

7 PË. Bedri Dervishaj

8 PY. Z. Dervishaj, a keni ndonjë nofkë, a keni pasë ndonjëherë
9 ndonjë nofkë në jetën tuaj?

10 PË. Jo.

11 PY. A mund të na thoni datën e lindjes dhe vendin e lindjes?

12 PË. Në 26 maj 1971, Prizren.

13 PY. Për qartësi, a mund të na thoni çfarë kombësie keni dhe
14 çfarë shtetësie?

15 PË. Shqiptar, kosovar.

16 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Dëshmitar, ju jeni shqiptar i
17 Kosovës. Gjatë kohës së luftës për çlirimin e Kosovës, ne do
18 t'ju bëjmë pyetje në lidhje me atë kohë, domethënë, kohën e
19 luftës për çlirimin e Kosovës. A e keni të qartë?

20 PË. Të qartë.

21 PY. Z. Dervishaj, para shpërthimit të luftës për çlirimin e
22 Kosovës në vitin 1998, ku ke jetu ti? Në cilin shtet?

23 PË. Në Prizren. Në 1998, kam shku për Gjermani.

24 PY. A ju bashkove përpjekjeve të luftës, domethënë, kur u bë
25 mobilizimi i përgjithshëm në Kosovë, a ju bashkove luftës?

1 PË. Po.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
3 Dëshmitar, ju lutem të flisni në mikrofon në mënyrë që t'ju
4 ndëgjojnë këta përkthyesit. Ju lutem, flisni pak më me zë --

5 DËSHMITARI: Okej.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] - dhe
7 nuk mjafton, për shembull, vetëm me kokë me bë po ose jo, por
8 duhet ta thoni këtë me fjalë, në mënyrë që të regjistrohet në
9 procesverbal.

10 Z. AOUINI: [Përkthim]

11 PY. Domethënë, z. Dëshmitar, ju na thatë që keni jetu në
12 Gjermani, që jeni shpërngul në Gjermani dhe se mandej jeni
13 bashku luftës.

14 Për ta pasë më të qartë, kur ju vendosët që t'i
15 bashkoheshit përpjekjeve të luftës dhe të mobilizoheshit, si
16 pjesa më e madhe e popullatës shqiptare të Kosovës, a e bëtë
17 këtë prej Gjermanie apo për këtë vendosët kur u kthyet në
18 Prizren? Që ta kemi të qartë.

19 PË. Jo, prej Gjermanie. Të organizum kemi ardhë.

20 PY. Faleminderit. A mundesh me na tregu se ku shkove? Si
21 udhëtove prej Gjermanie për t'ju bashku përpjekjeve të luftës?

22 PË. Në Ulm. Në Gjermani, në Ulm.

23 PY. Pyetja ime është kjo, z. Dervishaj. Domethënë, ke vendosë
24 t'i bashkohesh luftës prej Gjermanie? Si udhëtove prej
25 Gjermanie, ku shkove për t'ju bashku luftës? A shkove,

1 domethënë, në Kosovë? A shkove në Shqipni? A shkove në ndonjë
2 vend tjetër? Kjo është pyetja. Ku shkove prej Gjermanie për
3 t'ju bashku luftës?

4 PË. Në Shqipëri. Prej Gjermanie, Itali, Shqipëri. Edhe në
5 Shqipëri jemi mobilizu.

6 PY. Mirë. Domethënë, se keni shku i organizum. A mundesh me
7 na tregu se me çka ke udhëtu prej Gjermanie për në Itali,
8 domethënë, me çfarë mjeti transporti edhe kur ke shku në
9 Shqipëri ku ke mbërri në Shqipëri ose në Itali?

10 PË. Kemi ardhë me makina të organizum deri në Bari, në Bari
11 jemi tubu aty në traget dhe kemi mbërri në Durrës.

12 PY. Domethënë, keni mbërri në Durrës. Sa kohë qëndruat në
13 Durrës, sa ndejtët në Durrës, sa kohë?

14 PË. As dy orë. Kemi udhëtu për Kukës.

15 PY. Çka bëtë në Durrës nëse mundesh me na tregu?

16 PË. Na tregun, na ndanë do për -- na ndanë do i çun për
17 Koshare, do për Kukës.

18 PY. Na thatë që u mobilizut kur shkut në Shqipëri. Ky proces
19 i mobilizimit, a u kry, a u bë në Durrës apo u bë kur ju thanë
20 që me shku në Kukës?

21 PË. Jo, në Kukës kur kemi shku.

22 PY. Do të kthehemi pak më mbas me kohë. Në Durrës, gjatë
23 këtyne dy orëve që keni qëndru aty, a mundesh me na tregu se
24 kush vendosi, domethënë, kush e bëni atë ndamjen në grupe,
25 kush vendosi kush ka me shku në Kosharë e kush ka me shku në

1 Kukës?

2 PË. Nuk i njoh ata eprorë që na caktun, por e di që na ndanë.

3 Me emna nuk i mbaj mend.

4 PY. Në rregull. Na tregove se shkuat në Kukës, udhëtuat për
5 në Kukës. Me çfarë mjeti transporti udhëtuat për në Kukës?

6 PË. Autobus.

7 PY. A ishit vetë apo ishit me grup njerëzish?

8 PË. Jo, me grup. Kanë qenë nja 20 vetë kështu. Urdho.

9 PY. Shumë mirë. Z. Dervishaj, dua që shkurtimisht të na
10 tregosh vendet ku ke shku deri në fund të luftës. Domethënë,
11 mbasi ke shku në Kukës mbas asaj, na i trego shkurtimisht
12 krejt vendet ku ke udhëtu deri në fund të luftës.

13 PË. Prej aty keni në Kukës, jam mobilizu në repartin numër 1.
14 Prej njishit, kemi udhëtu për në Burrel. Kemi bërë stërvitjet në
15 Burrel, jemi përgatit. Mbasandaj kemi ardhun në Kalimash. Dhe
16 prej Kalimashit në vijë të frontit.

17 PY. Faleminderit shumë. Do t'i diskutojmë një nga një në
18 mënyrë që çdo fragment të këtij udhëtimit që ke bërë ta
19 diskutojmë veç e veç.

20 Na tregova se shkove në Kukës me autobus se ishit një
21 grup. A mundesh me na tregu se ku konkretisht në Kukës
22 mbërritët, në cilën pjesë të Kukësit?

23 PË. Në qendër. Afër Shote Galica ku është aty. Aty
24 mbasandajna do i çunë në dysh. Unë shkova në njësh. Në
25 repartin 1 dhe 2.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
2 mund t'ju pyes një pyetje, z. Avokat? Dua që ta përcaktoni
3 periudhën kohore për të cilën po flasim sepse momentalisht nuk
4 e kemi të qartë. E dëgjova një vit që u përmend, por gjithsesi
5 ta përcaktojmë kuadrin kohor.

6 Z. AOIINI: [Përkthim] Faleminderit.

7 PY. Z. Dervishaj, a të kujtohet se në cilën kohë, domethënë,
8 ndonjë datë, muaj, vit, përafërsisht kur keni mbërri në
9 Durrës?

10 PË. Muaj i dytë [shkurt] i 1999. Me datë nuk mbaj mend.

11 PY. Domethënë, dua ta kuptojmë se në shkurt të 1999 është
12 edhe e njëjta kohë kur keni mbërri edhe në Kukës?

13 PË. Po.

14 PY. A mund të lutem të përgjigjesh?

15 PË. Po, po. E njëjta po.

16 PY. Domethënë, keni mbërri në Kukës dhe ke shku te njësia 1?

17 PË. Po.

18 PY. Po së pari na trego, a të kujtohet sesa kohë, sa gjatë ke
19 qëndru në Kukës përpara se me shku në Burrel? A të kujtohet
20 përafërsisht se sa kohë ke qëndruar aty në Kukës?

21 PË. Afër një muaj.

22 PY. Z. Dervishaj, a ju bashkëve, a iu kyçe një grupi
23 specifik? Na tregove se u mobilizove dhe ju bashkëve njësisë
24 numër 1. A mund të na shpjegosh se çfarë do të thotë kjo?

25 PË. Repart a kanë. Qysh me të thanë ty? Do mobilizoheshin në

1 dysh, do në njësh. Dallim s'ka pasë.

2 PY. Domethënë, kur thu "repart" e ke fjalën për një vend,
3 domethënë, jo njësi që e ka emrin njësia numër 1?

4 PË. Jo, jo. Jo, vend u quajt ashtu.

5 PY. Faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
7 duhet më qartë ta kuptoj se ku ndodhej kjo njësi. Unë mund ta
8 bëj dhe vetë këtë t'i bëj pyetjet, por këtë po jua lë juve.

9 Z. AOUINI: [Përkthim] Do të nxjerrim dhe disa hollësi nga
10 dëshmitari dhe pastaj do t'i tregojmë një hartë ku do të
11 caktohen vendet, do të shënohen vendet.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
13 rregull atëherë. Mund të vazhdoni kështu.

14 Z. AOUINI: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, na tregove se ti shkove tek reparti numër 1.
16 Do të tregojmë pak më vonë një hartë të Kukësit, ku do të
17 shënosh përafërsisht se ku ndodhej ky vend në Kukës.

18 Mirëpo, për momentin, z. Dëshmitar, do të bëj disa pyetje
19 të shkurtra për rolin tënd. Kur mbërrine tek reparti numër 1,
20 a kishit ndonjë detyrë, cili ishte roli, detyra jote?

21 PË. Jo, unë veç ka qenë një ushtar i thjesht prej fillimit e
22 në mbarim. Veç kam zbatu urdhnat, s'kam pasë kurrfarë roli, as
23 kurrfarë nofke, as kurrfarë.

24 PY. A të kujtohet sesa njerëz ka pasë aty te reparti 1 kur
25 mbërri në atë kohë?

1 PË. Nuk e mbaj mend. Po afërsisht kur kemi shku, janë kanë
2 nja 20.

3 PY. Ky reparti numër 1, reparti 1, a mund të na e përshkruash
4 këtë ndërtesë apo këtë objekt? A ka qenë banesë, a ka qenë
5 hotel, a ka qenë fabrikë? A mundesh me na e përshkruajt se
6 çfarë objekti ishte ky reparti 1?

7 PË. Shtëpi me katër dhoma. Kurr gjë s'a kanë tjetër. Edhe sot
8 është ashtu, shtëpi është.

9 PY. Ti e përmende edhe repartin 2 apo njësinë 2. A mundesh me
10 na e përshkruajt edhe këtë repartin 2 se çfarë ka qenë, çfarë
11 objekti ka qenë?

12 PË. E di që, se s'kam shku atje, krejt dy herë kam shku për
13 me marrë injeksion për shpinën se jam smut. E di që a kanë
14 reparti i magazinave të municionit të Shqipërisë.

15 PY. A ka qenë shtëpi apo ka qenë një objekt më i madh se
16 shtëpia? Sa ju kujtohet?

17 PË. Më i madh, më i madh.

18 Z. AOUIINI: [Përkthim] Me lejen e Trupit Gjykses dua që
19 dëshmitarit t'ia tregojë një hartë të zonës së Kukësit në
20 mënyrë që t'i kërkojë dëshmitarit t'i shënojë aty vendet që i
21 përmendëm konkretisht.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Vazhdoni, znj. Sekretare.

24 Z. AOUIINI: [Përkthim] Dokumenti i parë ka numrin ERN
25 DPS01566 deri në DPS01568. Është një hartë prej Google e

Dëshmitari: Bedri Dervishaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Aouini

Faqe 22

1 Kukësit.

2 PY. Z. Dëshmitar, a mundesh në hartë, për shembull, me
3 identifiku, a sheh diçka që të orienton?

4 PË. Jo, s'po muj.

5 Z. AOUINI: [Përkthim] A të shkojmë tek faqja tjetër
6 ndoshta më mirë? Ku ka një pamje prej më afër.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Vazhdoni, znj. Sekretare, shkoni te faqja tjetër.

9 Z. AOUINI: [Përkthim]

10 PY. Z. Dëshmitar, do ta zmadhojmë këtë pjesën që është te
11 katrori i kuq.

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Dhe ajo do të dalë tek faqja tjetër
13 që do të tregohet në ekran. Ta zmadhojmë pak në mënyrë që të
14 shihet e gjithë pamja.

15 PY. Dëshmitar, a të ndihmon kjo pak? E shofim këtu një rrugë
16 kryesore, rrugën e Kumes dhe është një kryq aty, një udhëkryq.
17 A ndihmon kjo të orientohesh se ku është reparti 1 edhe 2 në
18 këtë fotografi?

19 PË. Nuk po muj me i ra në fije. S'po më kujtohen. Dhe janë ba
20 do vite që 25 vjet, s'po muj mi -- s'un po i bi në fije.

21 PY. Nuk është problem, Dëshmitar. Kurrfarë problemi nuk
22 është.

23 Z. Dëshmitar, na tregove se shkove --

24 Z. AOUINI: [Përkthim] Mund ta largojmë hartën nga ekрани.

25 PY. Na treguat që ishit i stacionum te reparti 1 dhe se

1 shkuat një apo dy herë te reparti 2, a është kjo e saktë?

2 PË. E saktë.

3 PY. A të kujtohet se gjithsej sa kohë, përafërsisht, ke qenë
4 i vendosun, i stacionum te reparti 1 duke fillu prej shkurtit
5 të 1999?

6 PË. Me datë nuk e di, po afërsisht një muaj qaty.

7 PY. Domethënë, shkove disa herë tek reparti numër 2.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kundërshtoj. Dy herë ka shku.
9 Ashtu tha dëshmitari.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
11 pajtohem me ju.

12 Z. AOUINI: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, na thatë se keni shku dy herë te reparti numër
14 2. A mund të na thoni se për çfarë qëllimi shkuat atje, çfarë
15 bëtë kur shkuat atje?

16 PË. Kam shku me marr nja dy injekese se jam prej shpinës smut
17 edhe prej veshëve jam smut. Edhe kam marrë injeksia.

18 PY. Z. Dëshmitar, ne do të tregojmë fotografi që si mbas nesh
19 janë fotografi të repartit 1 dhe do të kërkoj prej jush që të
20 na tregoni se në cilën pjesë të atij objekti që do ta shihni
21 në fotografi keni shku për të marrë injeksionin.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] T'i
23 kërkoj Sekretares, ta nxjerrë dëshmitarin prej salle.

24 Dëshmitar, do të dilni për disa minuta prej sallës dhe
25 pastaj do të ktheheni përsëri.

1 DËSHMITARI: Faleminderit.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

4 Avokat, do të kisha preferu sikur ta kishit fillu këtë pyetje
5 ndryshe, së pari duke e pyet dëshmitarin në qoftë se e ka të
6 njoftun atë pamje pa i tregu se çfarë mendoni ju se çfarë
7 tregohet aty në fotografi. Kjo do të ishte qasja më e hapur.
8 Kjo nuk ndryshohet sepse veç e keni thënë, por do t'ju kërkoj
9 që herën tjetër, së pari pyetni dëshmitarin dhe ne çdo herë
10 jemi të gatshëm të ndihmojmë në qoftë se ka nevojë t'ju
11 freskojmë kujtesën dëshmitarëve. Mirëpo tani është e pamundur
12 që ne ta dimë në qoftë se atij i kujtohet kjo ose jo.

13 Z. AOUBINI: [Përkthim] Nuk është çështje e njohjes sepse
14 është thjesht një pamje nga ajri edhe ne deshtëm që ta pyesnim
15 dëshmitarin në qoftë se e ka të njoftun atë objekt.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 rregull.

18 I kërkoj Sekretares që ta kthejë dëshmitarin në sallë.

19 [Dëshmitari vijon dëshminë]

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni
21 ju lutem. Mirë se erdhët përsëri.

22 Tash, përsëri do t'ia jap fjalën Avokatit të Mbrojtjes.

23 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit.

24 Ta vendosim në ekran dokumentin me numër SPOE00330362.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Sekretare, ju lutem vendosni këtë dokument në ekran.

2 Z. AOUINI: [Përkthim] Në qoftë se mund ta kthejmë në 90
3 shkallë këtë fotografi, do të jetë më e kuptimtë.

4 Faleminderit. Dhe ta zmadhojmë pak.

5 PY. Z. Dëshmitar, a e ke të njohur këtë që e sheh këtu në
6 fotografi? A ka kjo ndonjë kuptim për ty?

7 PË. Po e di që po më duket qa ai repart. S'po di ç'a me
8 thënë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cili
10 repart? Dëshmitar, cili repart?

11 DËSHMITARI: Dyshi po më duket. Se i madh është.

12 Z. AOUINI: [Përkthim]

13 PY. Nga kjo fotografi kështu, a je në gjendje me e shënu se
14 në cilën pjesë ke shku për me marrë injekcinë?

15 PË. Nuk po muj me ditë edhe himja ka ashtë. Te himja a kanë
16 qaty më nalt.

17 PY. Nuk ka kurrfarë problemi.

18 Z. AOUINI: [Përkthim] Mund të vazhdojmë në një mënyrë
19 tjetër, të nderuar Gjykatës.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Vazhdoni.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] A mund të vendosim në ekran
23 dokumentin SPOE40010264-40010559.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
25 të njëjtin qëllim, Avokat?

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Po. Për identifikim të mundshëm të
2 objektit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Vazhdoni, znj. Sekretare, vendosni këtë dokument në ekran.

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Ndoshta të fillojmë me faqen 2.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faqja
7 24, rreshti 4 i transkriptit, unë thashë "Po, vazhdoni", jo
8 "Vetëm vazhdoni".

9 Z. AOUINI: [Përkthim]

10 PY. A e këtë të njoftun këtë që e sheh në fotografi? A
11 identifikon ndonjë gjë në të?

12 PË. E di që ky reparti a kanë këtu. S'po muj.

13 PY. Kur e thu "reparti", të lutem shtojë, përmende edhe
14 numrin e repartit. Meqë janë dy që të jetë i qartë.

15 PË. Okej.

16 PY. Domethënë, ky që e pamë fotografi është reparti numër?

17 PË. Numër 2.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 Dëshmitar, a mundesh me na tregu se si e di ti që ky është
20 reparti 2, mbi çfarë baze e identifikon këtë në fotografi si
21 reparti 2?

22 PË. Kam qenë mbasandaj edhe pas luftës e kam vizitu.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
24 atëherë a mundesh me na tregu apo me thënë diçka në lidhje me
25 ndërtesat?

1 DËSHMITARI: S'po i di ndërtesat qetu, se s'kam nejt gjatë
2 luftës këtu. S'po di ça me thënë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Avokat, do t'ua lë juve, por për momentin identifikimi nuk
5 është i bazuar për momentin, dëshmitari thjesht e identifikon,
6 e sheh, e njeh atë që e ka pa përpara.

7 Z. AOUIINI: [Përkthim]

8 PY. Z. Dëshmitar, duam që ta kuptojmë, se çfarë të bën ty,
9 domethënë, kur e sheh këtë fotografi mbi çfarë baze ti e
10 dallon, e dikton që ky është reparti numër 2? A ka diçka
11 specifike që e sheh në fotografi që të shtin me mendu se është
12 reparti 2?

13 PË. Jo dhe aq. Po më duken qëta, qysh me të thanë, këta
14 kazermat qështu a kanë dhe oborri. Se jam kanë edhe njëherë
15 mbas luftës e kam vizitu një herë a dy. E po më kujtohet.
16 Tjetër send --

17 Z. AOUIINI: [Përkthim] A mund të shohim faqen numër 7.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Vazhdoni, ju lutem.

20 Z. AOUIINI: [Përkthim]

21 PY. Z. Dëshmitar, a e njihni këtë fotografi?

22 PË. Si objekt po më kujtohet që e kam mbas luftës. S'po më
23 kujtohet gjë në të, na një të veçantë.

24 Z. AOUIINI: [Përkthim] Shohim faqen 15, ju lutem.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Vazhdoni, Sekretare.

2 Z. AOUINI: [Përkthim]

3 PY. E njëjta pyetje. E njihni këtë vend?

4 PË. E këtu te hymja kam marrë injiksi. Te dera, te hymja aty.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

6 mund të na thoni tek cila derë, mund ta marrim vesh për cilën

7 derë bëhet fjalë?

8 DËSHMITARI: Te hymja.

9 Z. AOUINI: [Përkthim] Shumë. Do ta bëja këtë pyetje

10 PY. Dëshmitar, do t'ju ndihmojmë me një stilolaps do bëni një

11 shënim tek fotografia, aty ku thoni ju që është hymja.

12 PË. [Shënon]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit. A mund t'i shtoni dhe ndonjë shkronjë, ose numër

15 ose shkronjë?

16 Z. AOUINI: [Përkthim]

17 PY. Z. Dëshmitar, këtu ku bëtë shënimin vendosni numrin 1 për

18 hyrjen, që të identifikojmë hyrjen me numrin 1.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Avokat, mbase mund ta udhëzoni dëshmitarin të jetë më i saktë

21 se mua më duket pak e vështirë që të ketë hyrë që këtu.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Unë do ta pyesja në lidhje me këtë

23 tani.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

25 rregull.

1 Z. AOUINI: [Përkthim]

2 PY. Z. Dëshmitar, ju thatë që kjo është hymja, hymja ku keni
3 shkuar ju për të marrë injeksionin?

4 PË. Po.

5 PY. Edhe duam të na thoni me saktësi ose rrethojeni vendin
6 konkret, nëse duket nga fotografia, ku ua kanë bërë
7 injeksionin në këtë godinë nëse duket?

8 PË. Po, këtu është hymja. Këtu a kanë ajo që kam marrë
9 injeksin.

10 PY. Fillojmë edhe njëherë dhe a marrim më ngadalë. Vendos
11 numër 1 tek hymja, tek hymja që përmendët dhe numër 2 tek ajo
12 pjesë e ndërtesën ku ju kanë bërë injeksionin. Pra, 1 hymjen
13 dhe 2 tek vendi ku është bërë injeksioni.

14 PË. Këtu.

15 PY. Se t'i fshijmë njëherë këto që janë bërë në fillim që ta
16 kemi më të qartë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ja të
18 ruajmë njëherë këtë fotografinë. S'mund ta fshijmë. Sepse
19 është çështje procedurale, ta ruajmë njëherë këtë dhe e
20 fillojmë nga e para.

21 Sekretare, ruani këtë imazh fillimisht, vendosini dhe një
22 numër.

23 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
24 këshillohen]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

1 shënimet që bëri Dëshmitari D04-02 do të marrin numrin 00966.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit. Ruajeni fotografinë origjinale pa shënimet dhe

4 vendosni tani në ekran fotografinë origjinale pa shënime që të

5 vazhdojë Avokati me pyetjet përkatëse. Faleminderit.

6 Z. AOUINI: [Përkthim]

7 PY. Z. Dëshmitar, nëse është e mundur, që ta kuptojmë,

8 vendosni numër 1 tek hymja dhe numrin 2 tek pjesa e ndërtesës

9 ku keni marrë injeksionin.

10 PË. [Shënon]

11 PY. Faleminderit.

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kemi pyetje të

13 tjera tani. Fotografia nuk na duhet më. Kështu që mund ta

14 ruani me shënimet përkatëse dhe ne të vazhdojmë me pyetjet

15 tona.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

17 rregull. Faleminderit.

18 Sekretare, ruajeni fotografinë dhe jepini numër

19 fotografisë me shënimet.

20 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës

21 këshillohen]

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

23 shënimet që bëri dëshmitari do të marrin numrin e Zyrës

24 Administrative ERG967.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull. Faleminderit.

2 Vazhdoni, Avokat.

3 Z. AOUINI: [Përkthim]

4 PY. Z. Dervishaj, ju i vutë shënime vendit ku morën
5 injeksionin. A mund të na e përshkruani tani me fjalët tuaja,
6 si ishte nga brenda ky vendi? Domethënë, sa i madh ishte, ç
7 ishte, ç ambienti ishte?

8 PË. Një zyrë e vogël 2 me 1 q'ashtu. 2 metër me 2 q'ashtu. Ma
9 së shumti s'a kanë më e madhe. Qaty e kam marrë një injekcin
10 dhe kam dalë. Ma shumë s'kam nejt se dhjetë minuta.

11 PY. Nga ato vizita të shkurtra që ke bërë atje.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dy.

13 Z. AOUINI: [Përkthim] Dy thashë dhe unë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo
15 për siguri unë.

16 Z. AOUINI: [Përkthim] "Couple" thashë, domethënë, *couple*
17 në anglisht domethënë dy.

18 PY. Pra, nga ato dy vizita të shkurtra në atë vend, z.

19 Dëshmitar, a ju kujtohet ose ju ka ngelur ndonjë gjë në mendje
20 ç pajisjesh kishte atje, ç mobiliesh kishte, ç të kujtohet?
21 Çfarë mobiliesh, çfarë pajisjesh, ç veglash, ç kishte atje?

22 PË. Veç nja dy karriga janë kanë, një karrige me të drunit
23 dhe asgjë tjetër s'ka pasë. Qaty një çantë me barna.

24 PY. A kishte personel mjekësor atje, a kishte doktor a kishte
25 motra, a kishte ndonjë personel mjekësor?

1 PË. Veç mjeki aty a kanë. Ma dha një injekci për dhimt. Dhe
2 Ilir Rakaj a kanë.

3 PY. Ky doktori, të kujtohet, ça kishte veshë kur shkove ti ça
4 kishte veshur ai këto dy herët që kishe shkuar ti?

5 PË. Normal, me rroba ushtarake a kanë.

6 PY. Faleminderit. Z. Dëshmitar, ju thatë që u kyçët dhe
7 qëndronit në repartin numër 1, na e thatë sot kur filluam
8 seancën.

9 PË. Po, ashtu.

10 PY. A keni qenë -- si e kishte emrin grupi ku u kyçe ti, në
11 qoftë se ishte ndonjë grup, po i themi grup po mund të jetë
12 njësitë apo çfarëdo që të ishte, çfarë emri kishte?

13 PË. Jo. Veç. Si me të thënë ty? Një njësi e vogël a kanë.

14 Kemi nejt nja një muaj ditë aty parapërgatitje dhe kemi shku
15 për Burrel.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Avokat, dua t'i bëjë unë një pyetje që ta kuptojë më mirë.

18 Z. Dëshmitar, keni folur për këto dy raste që shkove tek
19 reparti 2 për injksionin. Kur ke shkuar te reparti 2 për
20 injksionet, domethënë, nëse të kujtohet cili muaj ka qenë?

21 PË. Ah, nuk muj me ditë me muaj me ditë. S'kam mujt me e
22 mbajt mend atë ditë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Se po
24 flasim për një periudhë kohore kur ke qëndruar në Kukës nga
25 shkurti 1999 -- ja një çast ta mbarojmë fjalinë ju lutem. Mos

1 më ndërpritni. E di që do të ma tregosh po duhet të përfundoj
2 unë pyetjen që të jetë e qartë.

3 Pra, ju thatë keni qëndruar një muaj dhe pastaj shkuaat në
4 Burrel nga shkurti i 1999 fillon.

5 DËSHMITARI: Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
7 pyetja ime është kështu: Atë muaj ke shkuaar te reparti 2, atë
8 muaj që ke qenë aty?

9 DËSHMITARI: Po, në muajin 2 [shkurt]. Se më s'kam qenë në
10 Kukës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit.

13 Avokat, vazhdoni.

14 Z. AOUINI: [Përkthim] Ju faleminderit.

15 PY. Para se të kalojmë në një aspekt tjetër, për t'u sqaruar.
16 Ju thatë që ishte një mjek, e kishte emrin Ilir Rekej.

17 PË. Rakaj

18 PY. Rakaj, më falni.

19 PY. Nga ia dini emrin këtij doktori?

20 PË. Një gjeneratë, jam kanë në shkollë.

21 PY. Pra, për sqarim, ato dy herë që keni shkuaar atje keni
22 takuar ndonjë personel tjetër mjekësor, përveç këtij doktori?

23 PË. Jo, jo. Veç me këtë kam shku se e kam njoftë, ma ka dhënë
24 injeksin për dhimt edhe kam vazhdu.

25 PY. Ti kthehemi qëndrimit tuaj në repartin 1. Grupi i

1 personave që përmendi më herët, pjesë e të cilit ishit dhe ju,
2 a kishe ndonjë emër, ndonjë inicial, si i drejtohej këtij
3 grupi, a ka ndonjë gjë që e identifikonte këtë njësi?

4 PË. Jo, jo. A kanë -- si me të thanë ty? Një njësi ku
5 rrijshim, përgatitjet që u bëjshin. Emën s'ka pasë. S'po di ç
6 me thënë, s'ka pasë emën. Veç gjatë përgatitjeve qat
7 rrijshim.

8 PY. Shumë mirë. Z. Dëshmitar, tani do t'ju pyes për disa
9 persona. Do ju bëj disa pyetje në seancë publike, pastaj do
10 kalojmë në seancë private që të mbrojmë identitetin e
11 personave.

12 Pyetja ime e parë është kjo, gjatë luftës, pra, nga
13 periudha që keni udhëtuar nga Gjermania derisa mbaroj lufta, a
14 keni takuar dikë me emrin a keni njohur apo keni takuar një
15 person me emrin Pjetër Shala?

16 PË. Jo, jo.

17 PY. Grupi apo grupet ku ishit dhe ju, në qoftë se ka pasur më
18 shumë se një, gjatë luftës, a kishte ndonjë në këto grupe, me
19 sa dini ju, a në qoftë se ju lejon kujtesa, a ka pasur ndonjë
20 person me emrin Pjetër Shala në grupet ku keni qenë dhe ju apo
21 formacionet tuaja?

22 PË. Jo, jo. Pjetër Shala nuk ka dëgju në grup tonë, po as në
23 Brigadë 128. Nuk ka pasë Pjetër Shala.

24 PY. Z. Dëshmitar, sa thatë Brigada 128?

25 PË. Po.

1 PY. Unë ju pyeta pak më përpara, nëse në shkurt të 1999, kur
2 shkove te reparti 1, ju pyeta a kishte ndonjë emër grupi apo
3 formacioni juaj?

4 PË. Jo, e ka marrë kur kemi hi në vijë të frontit e ka marrë
5 emnin. Mbas Kalimashit.

6 PY. Mirë atëherë unë po ju bëj një pyetje. Prisni vetëm të
7 mbaroj pyetja. Gjatë kohës keni qenë në repartin 1 në shkurt
8 të 1999, grupi ku ishe ti a kishe, a njihej si Brigada 128 në
9 atë kohë. E kuptova siç duhet, pra në atë kohë nuk ishte
10 kështu, apo jo?

11 PË. Nuk ishte. Nuk ishte ashtu. Nuk ishte ashtu.

12 PY. Në rregull atëherë. Vazhdojmë për Pjetër Shalën.

13 Z. AOUINI: [Përkthim] Me lejen e Trupit Gjykues duam t'i
14 tregojmë një fotografi dëshmitarit. Emrin nuk e njihte. Ne
15 tani duam t'i tregojmë një fotografi.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Vazhdoni, Sekretare e Gjykatës.

18 Z. AOUINI: [Përkthim] 059193-059144, faqja 13.

19 PY. Z. Dëshmitar, e njihni personin në fotografinë përballë
20 jush?

21 PË. Jo, jo.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Mund ta heqim fotografinë nga
23 ekrani.

24 PY. Dëshmitar --

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Vazhdoni.

2 Z. AOUINI: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, unë kam këtë pyetje për ju: A keni dëgjuar
4 gjë, a keni ditur gjë për ndonjë person që kishte nofkën Ujku?

5 PË. Nuk kam ndëgju. Pas luftës i kam ndëgju këto nofkat.

6 S'kam ndëgju.

7 PY. Pas luftës keni dëgju edhe për këtë nofkën Ujku?

8 PË. Pas luftës kam ndëgju shumë nofka janë kanë Ujku, nuk po
9 e di edhe shumë Gjarpna nuk e di sesa. Nuk e di kush a kanë,
10 kush s'a kanë. Pas lufte veç.

11 PY. Pra, pas luftës, a mund të na thuash çfarë do që të dish,
12 a di gjë për ndonjë person me emrin Ujku, çfarëdo që të dish
13 për këtë person, pas luftës domethënë?

14 PË. Po, për Pjetër Shalën kam dëgju këtu në televizion kur e
15 kam pa për herë të parë. Mbasandaj Ujku a ka një me Ramush
16 Haradinin, komandant Ujku. Ku e di unë se kush a kanë ai Ujku.
17 Veç kam ni, kam ndëgju që shumë Ujq, Ujku, Ujku, pseudonimin.

18 PY. Edhe njëherë, më falni që do ta bëj edhe njëherë pyetjen,
19 ju thatë, pastaj ishte dhe një tjetër me Ramush Haradinaj?

20 PË. Po.

21 PY. Veç një çast ta mbarojmë pyetjen. E keni fjalë një tjetër
22 përveç Pjetër Shalës --

23 PË. Po.

24 PY. -- që e kishte po ashtu nofkën Ujku, pra, një tjetër
25 përveç Pjetër Shalës deshët të thonit, apo jo?

1 PË. Po, po, përveç Pjetër Shalës që e kam ndëgju në televizor
2 Pjetër Shalën, ma vonë e kam ndigju, po për Ujku me Ramushin
3 kam dëgju pak më herët. A për Pjetrin kam ndëgju në televizor
4 se këtë s'e kam njoftë.

5 PY. Do ju bëj një pyetje tjetër në seancë publike dhe nëse
6 është nevoja dalim në seancë private. Për këtë personin tjetër
7 me të njëjtën nofkë a ke ndonjë informacion? Apo nuk ke?

8 PË. Jo, jo, nuk kam informacion. Veç kam ndëgju. Operacionet
9 kur u flitshin kam ndëgju operacioni komandant Ujku që atëherë
10 mbas luftës. Se s'kam ndëgju, s'ia di emrin.

11 PY. Për sqarim, nëse të kujtohet, the që pas luftës e kam
12 dëgjuar, po kur e ke dëgjuar këtë informacionin e fundit që na
13 the?

14 PË. Po kur u tregojshin operacionet si kanë veprue të luftës,
15 nëpër televizione, nëpër reparte, nëpër shtabe pas luftës.

16 PY. Nëse të kujtohet, e kuptoj që the që e ke parë në
17 televizor. Po kur e ke dëgjuar, a ka pasë ndonjë burim tjetër
18 përveç televizorit a ke pasë ndonjë burim tjetër ku e ke
19 dëgjuar këtë nofkë?

20 PË. Jo, jo.

21 PY. Faleminderit. Shumë mirë.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Në nderuar Gjykatës, duam t'i bëjmë
23 disa pyetje për disa emra, do ta bëjmë brenda kohës që na ka
24 mbetur në seancë private.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Kalojmë në seancë private, ju lutem.

2 Kanë ngelur edhe pesë minuta, Avokat, para se të bëjmë
3 pushimin e parë.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bedri Dervishaj (Seancë private)
Pyetje nga z. Aouini

Faqe 39

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bedri Dervishaj (Seancë private)
Pyetje nga z. Aouini

Faqe 40

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit.

15 Z. Dëshmitar, tani do të bëjmë gjysëm ore pushim,

16 Asistentja do ju shoqërojë jashtë sallës së gjyqit. Dhe ne do

17 të shihemi përsëri në orën 11.30.

18 DËSHMITARI: Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit ju.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ka

23 gjë që duan të parashtrojnë palët dhe Mbrojtësi i Viktimave?

24 Në rregull. Atëherë shihemi për gjysëm ore.

25 --- Pauza fillon në orën 11.01

1 --- Seanca rifillon në orën 11.31

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Përpara se të vazhdojmë me dëshminë e z. Dervishaj, shoh që
4 kemi të njëjtën pjesëmarrje nga Prokuroria, Mbrojtësi i
5 Viktimave, dhe Mbrojtja që po pohojnë me kokë. Në rregull.

6 Z. Shala, e merrni përkthimin, e dëgjoni?

7 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e ndëgjoj mirë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit.

10 Znj. Sekretare, sillni dëshmitarin në Sallë.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dua që të konfirmoj edhe një
12 herë disponueshmërinë tonë në lidhje me seancat shtesë që i
13 përmendët.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju,
15 faleminderit. Mirë është që të dimë në qoftë se do të ketë
16 seanca.

17 Dhe atëherë mund të na tregoni mbas drekës se kur do ta
18 keni këtë informacion.

19 [Dëshmitari vijon dëshminë]

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
21 se erdhe përsëri, dëshmitar.

22 DËSHMITARI: Faleminderit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A më
24 dëgjon?

25 DËSHMITARI: Po, po.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
2 mirë. Z. Shala, a e ndëgjoni dëshmitarin?

3 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Po, ndëgjoj shumë mirë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
5 mirë, faleminderit.

6 Z. Avokat, mund të vazhdoni me pyetjet për këtë
7 dëshmitar. Urdhëroni.

8 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit.

9 PY. Mirë se u kthytë, dëshmitar.

10 PË. Faleminderit.

11 PY. Na tregutë sot në mëngjes se prej Kukësit shkutë në
12 Burrel. Tani do të flasim pak për Burrelin.

13 A mundesh me na tregu se me çfarë mjeti të transportit
14 keni shku prej Kukësit për në Burrel?

15 PË. Me autobus, privat.

16 PY. A të kujtohet përafërsisht se në cilin muaj të 1999 ka
17 qenë kjo, kur keni shku prej Kukësit në Burrel?

18 PË. Nuk i mbaj mend ditët, nuk i di.

19 PY. Atëherë do të përpiqemi që ta qartësojmë periudhën kohore
20 nëpërmjet pyetjeve. A mundesh me na tregu se sa kohë qëndrutë
21 në Burrel, sa gjatë ndejtët në Burrel?

22 PË. Nja dy javë.

23 PY. A të kujtohet se sa i madh ishte grupi që udhëtutë me
24 autobus, domethënë sa vetë ka pasë në atë grup që e ka bo atë
25 udhëtim?

1 PË. Janë kanë nja dy autobusa, më kujtohet.

2 PY. Çka bëtë në Burrel?

3 PË. U stërvitshim, ushtrime për me gjujtë e për qysh me u
4 mbrojtë, e qesi.

5 PY. A të kujtohet se kush ju ka stërvitë?

6 PË. Po.

7 PY. A mundesh me na tregu se kush?

8 PË. Mu personalisht me një njësiti, nja 20 vetëve, Adem Shehi.

9 PY. A mundesh me na tregu se kush ishte Adem Shehu?

10 PË. Adem Shehi ishte një epror i Ushtrisë së Shqipërisë, që
11 na ka stërvitë.

12 PY. Z. Dëshmitar, a keni dijeni për ndonjë incident apo a cka
13 ndodhë ndonjë incident gjatë kohës që ke qenë në Burrel?

14 PË. Po, kemi ndigju për atë incident. Na jemi kanë në
15 stërvitje kur ka ndodhë ai incident.

16 PY. Për t'u siguru se po flasim për të njëjtën gjë, a mundesh
17 me na e spjegu se çfarë incidenti ndodhi?

18 PË. Po ne jemi kanë në stërvitje, kur erdhën thanë u vra një
19 ushtar, në njëfarë incidenti, masanej aty e ditshim.

20 PY. Na thatë që keni ndenjtë në Burrel dy javë. A mundesh me
21 na tregu për afërsisht kur ka qenë kjo në fillim të ktyne dy
22 javëve, në mes të këtyne dy javëve, apo nga fundi i këtyne dy
23 javëve që keni ndejtë në Burrel, kur keni ndigju për këtë
24 incident?

25 PË. Është kanë në fillim. Në fund të dy javëve, masanej kur

1 ka ndodhë na u largumë se thamë -- u tut oficeri i Shqipërisë,
2 tërhiquni qysh të mundni. Se mos po bahet ndonjë vrasje ma e
3 madhe. Dhe jemi tërhjekë, kemi ardhë në Kukës.

4 PY. Sa për të qenë të qartë në transkript. Kemi dy deklaratata
5 kundërshtuese. Ju thatë në fillim, edhe mandej në fund të dy
6 javëve. Sa për të qenë të qartë, a mund të na thuash ma qartë
7 domethënë kur ka qenë kur ke ndjigju për këtë incident, në
8 fillim të këtyne dy javëve, apo në fund të këtyne dy javëve?

9 PË. Jo në fillim, në fund të dy javëve ka ndodhë. Kur ka
10 ndodhë ky incident ne jemi tërhjekë, jo në fillim.

11 PY. Faleminderit që na e qartësove këtë. Na tregove se ishte
12 vra një ushtar. A ke informacion se kush ishte ky ushtari?

13 PË. Po, ushtarin unë e kam mik të shtëpisë.

14 PY. A ia din emrin?

15 PË. Po, Halil Gashi.

16 PY. Z. Dëshmitar, nga dëshmia jote, e kemi të qartë se keni
17 qenë tu u stërvitë kur keni ndigju për këtë incidentin.

18 Domethënë, del se incidenti nuk ka ndodhë në vendin ku jeni
19 stërvitë. A din ti se ku, në çfarë vendi ndodhi incidenti?

20 PË. Brenda në repart ka ndodhë, ne jemi kanë në stërvitje.

21 PY. Z. Dëshmitar, po përpigem me kuptu periudhën, kuadrin
22 kohor. Kemi informacion publik që një zotni me emrin Halil
23 Gashi ka vdekë më datën 2 maj 1999. A përputhet kjo me atë që
24 mban mend ti, kjo datë?

25 PË. Përputhet, përputhet.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
2 si përputhet?

3 DËSHMITARI: Por ne kemi qenë në stërvitje kur u vra. Në
4 qatë kohë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Atëherë në qoftë se të kam kuptu drejt, ajo që të kujtohet ty
7 është se kur ka vdekë ky personi, ju keni qenë në stërvitje. A
8 të kujtohet data ose muaji, muaji, kur ka ndodhë kjo?

9 DËSHMITARI: Jo, nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
11 ndryshe, z. Avokat. Nuk është e njëjta gjë.

12 Z. AOUINI: [Përkthim]

13 PY. Për të qartësu periudhën kohore.

14 Prej Kukësit keni shku drejt në Burrel, keni ndejtë aty
15 dy javë, dhe atëherë mbrenda këtyne dy javëve ka ndodhë ky
16 incident. Kjo është periudha, apo ecuria e kohës që ju
17 kujtohet ju?

18 PË. Po qe kjo periudha e kohës si më kujtohet. Data nuk di,
19 veç kjo periudha është. Qe kjo kohë është, shkurt.

20 PY. Faleminderit z. Dëshmitar. Në faqen 40 të transkriptit
21 paraprak, apo jopërfundimtar të seancës së sotshme, në
22 rreshtat 14 dhe 15 ju thatë se mbase incidentit ju shkutë, u
23 tërhoqët. A është kjo e saktë?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. A mundesh me na spjegu të lutem, reagimin prej momentit

1 kur ndigjutë për këtë incident e derisa ndërmoret veprim dhe u
2 tërhoqët, domethënë çfarë reagimi patë?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Reagimin e kujt e keni fjalën, Avokat? Reagimin e kujt?

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Dëshmitari tha "ne shkumë, u
6 tërhoqëm". Do përpiqem që ta qartësoj këtë.

7 PY. Në transkriptin e ditës së sotshme, faqja 40, rreshtat
8 14-15, ju thatë "shkuam, u tërhoqëm" a e kishit fjalën për
9 grupin që po stërvitej apo për grupin që udhëtoi prej Kukësi
10 në Burrel? Domethënë a mundesh me na tregu qartë se kush u
11 tërhoq, kush shkoi?

12 PË. Grupi që ishna tu u stërvitë.

13 PY. Kur shkove, ose kur shkutë si grup, ku shkutë, në çfarë
14 vendi?

15 PË. Në Kukës.

16 PY. A mundesh me na tregu se sa kohë zgjati udhëtimi prej
17 Burreli në Kukës? Mbas incidentit, kur u tërhoqët, sa kohë
18 zgjati ky udhëtim?

19 PË. Po rrugët e këqija janë kanë në atë kohë. Aty ka zgjatë
20 katër-pesë orë të mira, pesë të plota.

21 PY. Më fal që po kthehena ma mbas, kur keni udhëtu tash prej
22 Kukësit për në Burrel, kur shkutë për në Burrel, sa kohë
23 zgjati ai udhëtim? A zgjati përafërsisht njësoj si në kthim
24 apo sa kohë zgjati?

25 PË. Njësoj, njësoj.

1 PY. A të kujtohet se sa kohë ndërmjet incidentit dhe kthimit
2 prej Kukësit në Burrel, domethënë prej kohës kur ndodhi
3 incidenti e derisa u kthytë në Burrel, sa kohë zgjati
4 ndërmjet?

5 PË. Po prej kur kemi shku e deri kur jemi kthy, dy javë, qe
6 aq. 10, 12 ditë.

7 PY. Vetëm për të qenë të qartë, më fal. Prej grupit,
8 domethënë prej momentit kur grupi shkoi prej Kukësit në
9 Burrel, edhe kur u kthy prej Burrelit në Kukës, kjo periudhë
10 ka qenë afërsisht 12 ditë, a është kështu?

11 PË. Kështu, dy javë, 12 ditë.

12 PY. Atëherë, a mundesh me na tregu se me çfarë mjeti
13 transporti u kthytë prej Burrelit në Kukës?

14 PË. Me autobusa të Shqipërisë, hypëm qysh mujshim.

15 PY. A mundesh me na tregu se ku në Kukës shkutë kur u kthytë
16 prej Burreli?

17 PË. Po në Kukës e kam pas -- nëpër familje, se i kemi pasë
18 familjet shumica në Kukës.

19 PY. Domethënë, kur u kthytë prej Burreli shkutë në Kukës, por
20 shkutë te familjet. A të kam kuptu drejt?

21 PË. Po, po. Mirë.

22 PY. Sa kohë kalove në Kukës me familjen, domethënë mbas
23 kthimit prej Burreli, sa kohë qëndrove në Kukës me familjen?

24 PË. Afërsisht, afërsisht nja gjashtë, shtatë ditë. Qe aty
25 parti [fonetkisht]. Masanejna na thirrën. U mobilizumë në

1 Kalimash.

2 PY. Përpara se të kalojmë në Kalimash, kam disa pyetje. A të
3 kujtohet se ku në Kukës, në cilën pjesë të Kukësit ke ndejtë
4 me familjen?

5 PË. Ia kam harru emrin rrugicave që -- di që qaty me një
6 ndërtesë në qendër.

7 PY. Në faqen 43, rreshtat 18 e në vijim, na thatë që:

8 "Na kanë thirrë edhe u mobilizumë në Kalimash."

9 A mundesh me na e shpjegu procesin, çfarë ndodhi që të
10 shtyni me shku prej Kukësit ku qëndroje me familjen në
11 Kalimash? Çfarë ndodhi?

12 PË. Po na thirrën për mobilizim për me hi në vijë të frontit.

13 PY. A të kujtohet se kush ua dha këtë informacion? Domethënë,
14 kush ju njoftoi që ti edhe grupi duhej të mobilizoheshit në
15 Kalimash? Kush ua dha këtë lajmin?

16 PË. Po na kemi qenë non-stop në lidhje që -- se na e kena
17 ditë që apet do të mobilizohemi dhe do të -- por përndryshe
18 komandanti Ruzhdija.

19 PY. Faleminderit. Sa vetë ishit në grup, në atë grupin që
20 shkoi prej Kukësit në Kalimash?

21 PË. Afërisht ishim një 20 vetë, qysh ishna q' ai grupi që
22 stërviteshna.

23 PY. A të kujtohet se me çka shkutë prej Kukësit në Kalimash,
24 me çfarë mjete të transportit?

25 PË. Po, e kemi pasë autobusat e Zhur Tours-it, privat.

1 PY. Z. Dëshmitar, sa kohë ndejtët në Kalimash? Sa kohë
2 qëndrutë aty?

3 PË. Po edhe aty kemi ndejtë afërsisht nja ma shumë se dy
4 javë, edhe pastaj jemi nisë për në vijë të frontit.

5 PY. A mundesh me na tregu në qoftë se të kujtohet, se çfarë
6 bëni grupi jot gjatë atyne dy javëve në Kalimash?

7 PË. Po stër vitje bojshim. Si me i përdorë armët, se me u
8 mbrojtë. Qesi ushtrime të përgjithshme luftarake.

9 PY. Faleminderit shumë. Na tregove se prej Kalimashit u nisët
10 për vijën e frontit. Pyetja ime është kjo: A të kujtohet
11 për afërsisht se në cilin muaj shkove në vijë të frontit, në
12 vitin 1999? A të kujtohet për afërsisht muaji cili ka qenë?

13 PË. Ah, nuk po më kujtohet muajt, s'mund me folë saktë. Jemi
14 kanë të traumatizumë, tash s'po di çka me të thanë.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund të sugjeroj një gjë. Mu
16 më duket se në faqen 42 të transkriptit, rreshtat 22, 23 dhe
17 24, Avokati bëni një pyetje, mendoj që dëshmitari nuk u
18 përgjigj në atë pyetje dhe ndoshta përgjigja që e tha ai ma
19 vonë në lidhje me ato pesë ditë deri në dy javë, ndoshta mund
20 të ndihmojë që ta qartësojmë periudhën, kuadrin kohor të
21 ngjarjeve.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
23 ta bëjmë këtë. Ndoshta është më mirë që dëshmitari të dalë
24 prej sallës dhe ta diskutojmë.

25 Dëshmitar, Sekretarja ka me të shoqnu jashtë sallës dhe

1 mbas pesë minutash do të ktheheni përsëri në sallë.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo
4 që kuptova prej përgjigjes së dëshmitarit, ishte 12 ditë prej
5 datës kur u ka shku në Burrel edhe kur është kthy. Por pyetja
6 juaj ishte midis incidentit dhe momentit kur shkutë në Kukës.
7 Meqenëse dëshmitari tha se ka qenë në pjesën e dytë apo në
8 fund të periudhës që ka qenë në Burrel, unë e kuptova -- dhe
9 ndoshta nuk duhej të mendoj shumë për ju, por nënkuptohej
10 përgjigjja sepse dëshmitari nuk mund të jetë i saktë me datat,
11 domethënë, të thotë saktësisht ishte dita e shtatë apo dita e
12 dymbëdhjetë prej atyne dy javëve.

13 Kështu e interpretova unë dhe prandaj nuk bëna pyetje të
14 tjera. Në qoftë se ka diçka që duhet të shtohet, për t'i bo
15 gjanat ma konkrete atëherë ndoshta, Prokuror, ju mendoni se
16 duhet të parashtrohet ndonjë pyetje shtesë për sqarim?

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ne po përpigemi që dëshmitari
18 t'i kujtojë ma mirë datat. Dëshmitari tha se kur shkoi në
19 Kukës qëndroi pesë apo gjashtë ditë. Dhe mandej tha që mbas dy
20 javësh shkoi në Kalimash. Dhe aty ndejti rreth dy javë. Kështu
21 që duhet ta dimë ma konkretisht se në çfarë date u kthy
22 dëshmitari në Kukës.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
24 t'ia lë Mbrojtësit në qoftë se don të vazhdojë me këto pyetje,
25 dhe pastaj Prokurori në pyetjet e veta do të ketë mundësi që

1 ta qartësojë këtë me dëshmitarin. Por, mendoj që do e ndihmoj
2 që të jemi sa më konkretë në këtë aspekt, se çdo gjë mund të
3 na ndihmojë. Mund të ndihmojë komenti i Prokurorit, por ua lë
4 përsëri juve që ta qartësoni periudhën kohore.

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Ne kuptojmë kështu. Meqë ka kalu dy
6 javë në Burrel mbas incidentit, ne e interpretojmë në të
7 njëjtën mënyrë si ju. Meqë nuk mund të konfirmojë dëshmitari
8 datën e 2 majit, ai tha përafërsisht dy javë herën e parë dhe
9 rreth 12 ditë mbas udhëtimit nga fundi i asaj periudhës
10 dyjavore që ka qëndru aty se ka ndodhë incidenti. Dhe besoj që
11 është disa ditë mbas vdekjes së atij ushtari që mund ta
12 vendosim datën kur ai është kthi në Kukës. Domethënë, dikund
13 gjashtë apo shtatë ditë ma pas.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Meqë
15 jeni ju duke e marrë në pyetje dëshmitarin, mendoj që për të
16 qenë ma të qartë, duhet t'i bëni pyetje dëshmitarit, ta pyetni
17 në qoftë se i kujtohet se kur është nisë për në Kukës mbas
18 incidentit. A ka qenë një ditë mbas, apo dy ditë apo tre ditë
19 mbas incidentit? Domethënë mund ta pyetni me një numër konkret
20 përpara, sa ditë. Se ndryshe mund të shkaktojë ngatërresa.

21 Znj. Sekretare, a mund ta ktheni dëshmitarin në sallë, ju
22 lutem?

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
25 se erdhët, dëshmitar.

1 DËSHMITARI: Faleminderit.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A më
3 ndëgjjon?

4 DËSHMITARI: Po, po.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
6 mirë.

7 Edhe ju z. Shala më ndëgjoni, apo jo?

8 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Po, po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Avokat e keni fjalën.

11 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Z. Dervishaj. Do të kthehemi pak mbas, prapë do të
13 kthehemi te Burreli. Për ta qartësu kronologjinë e ngjarjeve,
14 radhitjen e ngjarjeve, se është me rëndësi për Gjykatën.

15 Ju na tregutë që ky ushtari, Halil Gashi, u vra veçse
16 mbas vrasjes së tij ju u largutë. A mund të përqendrohesh të
17 lutem, a të kujtohet se sa kohë kaloi prej vdekjes, domethënë,
18 momentit kur more vesht që ishte vra Halil Gashi, e deri në
19 momentin kur u nisët prej Burreli për në Kukës? A kalunë disa
20 orë, një ditë, dy ditë, tre ditë? Domethënë, sa kohë ka kalu
21 prej momentit kur morët vesht për vdekjen e këtij ushtari, e
22 deri në momentin kur u nisët prej Kukësi -- prej Burreli për
23 në Kukës?

24 PË. Kur kemi marrë vesh që u vra Halil Gashi, oficeri Adem
25 Shehi na dha urdhën që të tërhiqemi, mos bo bohet alarm masiv,

1 përmbrenda dy orëve jemi largu. Tamam u qetësu pak edhe

2 situata edhe na jemi largu. Me gjithë Adem Shehin.

3 PY. Faleminderit. Tani është e qartë.

4 Shkumë pak më përpara në kohë. Domethënë na tregove që ke

5 kalu një kohë me familjen në Kukës, mandej je mobilizu, keni

6 shku në Kalimash, na tregove që keni kalu dy javë në Kalimash,

7 në stërvitje, përgatitje, edhe mbërrijmë te pika kur keni shku

8 te vija e frontit.

9 Z. Dervishaj, a mundesh me na tregu se sa kohë ke qëndru

10 në vijë të frontit?

11 PË. Afërsisht për një muaj e ma tepër. Afërsisht, se nuk

12 mban mend data. Qe 25 vite dhe jemi kanë me trauma, me data

13 nuk...

14 PY. Faleminderit. Dhe ne e çmojmë përpjekjen që e bën për t'i

15 mbajtë mend datat.

16 A mundesh me na tregu në qoftë se ke qëndru në vijë të

17 frontit deri në fund të luftës? A ke qenë në vijë të frontit

18 derisa ka përfundu lufta?

19 PË. Po, deri në ditën e fundit.

20 PY. Do flasim më konkretisht pak më vonë për këtë. Por kam

21 një pyetje për periudhën kohore që ke qëndruar në front të

22 luftës, në vijë të frontit. A të kujtohet ndonjë ushtar në

23 grupin tënd të jetë plagosur gjatë kohës që ke qenë në vijën e

24 frontit? Pra ndonjë nga ushtarët e grupit tuaj, u plagos gjatë

25 kohës që ishit në front?

1 PË. Halil Saramati, veshin -- në vesh është plagu.

2 PY. A ju kujtohet nëse vdiq ndonjë ushtar në fushëbetejë nga
3 grupi juaj gjatë kohës së keni qenë në front?

4 PË. Grupi jem jo, veç të plagumë ka pasë.

5 PY. Po këtij ushtarit që përmendët ju, Halil Saramatit, e
6 dini çfarë i ndodhi?

7 PË. Po, granata i ka ra. E ka rrokë përfshitë [fonetikisht].

8 PY. A ke ndonjë informacion sesi u trajtua nga pikëpamja
9 mjekësore, në qoftë se mori ndonjë trajtim mjekësor?

10 PË. Nuk e di, e kemi tërhjekë prej vijës së frontit, mandej
11 mjekësia janë marrë.

12 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Ju thatë që qëndruat në vijën
13 e frontit deri në ditën e fundit të luftës. A mund të na
14 shpjegosh kohën, por gjithashtu edhe si e kuptuat ju që
15 përfundoi lufta dhe u tërhoqët më pas nga vija e frontit, si u
16 shpalosën ngjarjet? Pra nga e kuptuat ju që lufta përfundoi,
17 dhe çfarë ndodhi ndërkohë?

18 PË. Ngjarjen e vërtetumë krejt kollaj, se gjujti NATO dhe u
19 dijke ajo. Në forcat serbe gjujti NATO dhe mandej edhe na u
20 dha urdhën me ecë përpara, me hi në Kosovë. Këta urdhna kanë
21 ardhë prej komandantit, jo prej meje, se unë s'kam pasë as
22 radiolidhje as...

23 PY. A ju kujtohet kur u tërhoqët, ku shkuat? Shkuat në ndonjë
24 qytet, a ndonjë zonë?

25 PË. Në shkollë të Gorozhupit. Kemi qëndru edhe aty afërsisht

1 nja nji javë, po. Gjashtë, shtatë, tetë ditë, kështu.

2 PY. Zoti -- si e kishte, Gorozhop?

3 PË. Gorozhup.

4 PY. Faleminderit. Për transkriptin këtë. A ju kujtohet në ato
5 momente, cili muaj, domethënë kjo kohë, në cilin muaj të vitit
6 ka qenë?

7 PË. Po muaji i fundit ka qenë, kur gjujti NATO ma -- në fund.
8 Se ne të mbramtë kemi -- zona operative e Pashtrikut të
9 mbramtë kemi hi në qytet.

10 PY. Më falni t'ju pyes dhe një herë. Në Gorozhup sa kohë
11 qëndruat?

12 PË. Po nja afërsisht nja tetë ditë, qeshtu. Në shkollë
13 mbrenda të Gorozhupit.

14 PY. Z. Dëshmitar, ka qenë i njëjti grup apo ka qenë grup
15 tjetër?

16 PË. Jo, krejt atje, krejt grupat kemi -- në shkollë të
17 Gorozhupit jemi tubu krejt.

18 PY. Çfarë bëtë këto tetë ditë që ishit atje? Më duket se tetë
19 ditë thatë. Çfarë bëtë në Gorozhup këto tetë ditë ju?

20 PË. Po ndejtëm se s'na kanë dhanë urdhën, se mos po vijmë në
21 mina të NATO-s, na ndalunë ta pastrojnë rrugën. Se nji shok na
22 ka ra në mina në Gorozhup kur kemi hi.

23 PY. A ju kujtohet emri i këtij shokut që vdiq?

24 PË. Jo, nuk ka vdekë. Këmbën e ka këputë, edhe në fytyrë
25 është i dëmtumë. Gjallë është, por këmbën e ka të këputme

1 krejt.

2 PY. Faleminderit. Se në transkript doli vdiq, por shumë mirë
3 që e sqaruam.

4 Pas këtyne tetë ditëve në Gorozhup ku shkuat?

5 PË. U nisëm për Nashec, për me hy mbrenda në qytet, edhe u
6 ndalëm në Nashec.

7 PY. Sa kohë qëndruat në Nashec, në qoftë se ju kujtohet, si
8 grup?

9 PË. Kemi qëndru gatë aty, deri në formimin e TMK-së.

10 PY. Z. Dëshmitar, tani mbërritëm një periudhë kohore pas
11 kohës së luftës, në Gorozhup. Ju na thatë që Brigada 128 u
12 formua pas vijës së frontit.

13 PË. U formu në vijë të frontit. Po.

14 PY. Mund të na shpjegoni këtë identifikimin e këtij grupi, më
15 saktë, kur ndodhi saktësisht? Kur u vu ky emër apo numër?

16 PË. Ah, nuk e di se unë nuk kam qenë në udhëheqjen e brigadës
17 udhëheqëse. Unë kam qenë veçse një ushtar i thjeshtë. Nuk muj
18 me i ditë ata çka kanë formu, kur janë formu.

19 PY. Pyetja në fakt është shumë e thjeshtë. Pyetja ime është
20 kjo: Pas vijës së frontit, në ç'moment e kuptove që grupi
21 kishte një emër apo një numër? Konkretisht Brigada 128? Ju
22 personalisht, kur e kuptuat që grupi ku ndodheshit ju kishte
23 një emërtim?

24 PË. Kur kemi mbërrirë në Gorozhup. Kur jemi tubu krejt aty,
25 bashkë kur jemi tubu, atëherë kam -- e kam marrë vesh që e ka

1 emrin Brigada 128.

2 PY. Faleminderit. Të flasim për Nashevcin tani. Dhe thatë që
3 qëndruat në Nashec derisa u formua TMK-ja. Mund të na
4 shpjegoni çfarë bëtë në Nashec ju në këtë periudhë?

5 PË. Po kemi ndejtë roje q'ashtu, kemi mbikëqyrë. Gjana me
6 randësi jo. Veç rrijshim roje sa me rujtë objektin.

7 PY. A ju kujtohet afërsisht sa kohë kalove ti dhe grupi juaj
8 në Nashevc?

9 PË. Unë kam shku me ndejtë në shtëpi. Kam këqyr familjen a e
10 kam gjallë, se prej Nashecit i ka një kilometër e gjysmë, dy
11 s'i ka. Edhe kam shku familjen e kam kërku, dhe masanej nja
12 nji muaj s'jam kthy tu e gjetë familje, se s'e kam ditë a i
13 kam gjallë.

14 PY. Faleminderit për përgjigjen, por s'e kisha tamam këtu
15 pyetjen. Pyetjen e kisha kështu: Në qoftë se të kujtohet, sa
16 kohë ky grupi që më pas u bë Brigada 128, qëndroi -- pra grupi
17 sa kohë qëndroi në Nashec gjithsej?

18 PË. Deri në formimin e TMK-së, masanej i kanë çu për në Zym
19 të Hasit, para formimit të TMK-së, e kanë çu për në Zym -- të
20 Tropojës në të vërtetë, më falni, në Zym të Tropojës. Masanej
21 ka hi tjetërkush aty.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
23 përshtypjen që prapë s'po e kupton pyetjen dëshmitari.

24 Megjithëse pyetja e qartë është. A mundem ta provoj unë më
25 thjesht, do përsëris atë që thatë ju?

1 Z. Dëshmitar, sa kohë, sa kohë, sa kohë qëndruat, sa kohë
2 shpenzutë, sa kohë qëndruat në Nashevc? Sa kohë?

3 DËSHMITARI: Po nuk po e di --

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vetëm
5 në -- më falni që ju ndërpreva. Një përgjigje, në qoftë se ju
6 kujtohet, dhe të na e thuash me ditë, pra ne duam të dimë sa
7 ditë a, sa javë a.

8 DËSHMITARI: Nuk e di, se deri -- kam shku e kam kërku
9 familjen se nuk e kam ditë a i kam gjallë. Se bash familjen e
10 ngushtë, shoqen edhe djalin s'i kam ditë a janë gjallë a
11 s'janë. Se kanë qellu te miqtë në Krushë kur është ba masakra
12 ma e madhe.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
14 në qoftë se e kuptova unë siç duhet -- dhe po e përdor, po e
15 përmbledh me fjalët e mia -- ju keni qenë kaq i shqetësuar
16 saqë nuk ju kujtohet koha, thjesht kishe mendjen të kërkoje
17 familjen, kështu? S'e ke pasë mendjen, s'ke qenë i qetë,
18 kështu?

19 DËSHMITARI: Kur mundesh me kanë i qetë kur s'e din
20 familjen e ke gjallë?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
22 e qartë kjo gjë, absolutisht. Thjesht ne po përpiqemi të
23 kuptojmë, po përpiqemi ta kuptonim pse s'po i përgjigjeshit
24 pyetjes tamam siç u bë.

25 DËSHMITARI: Më vjen keq që s'ju përgjigja se nuk po e

1 mbaj mend se nuk -- me trauma, se s'e kam ditë a i kam

2 familjen gjallë. Masanej -- kam shku familjen me lypë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit.

5 Avokat, vazhdoni.

6 Z. AOIINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

7 PY. Dhe faleminderit ju, dëshmitar. E gjete familjen?

8 PË. Kam shku prej shtëpisë e kam pa shtëpinë e kallme, kam
9 shku te miqtë. Masanej kur kam shku te miqtë si i kam gjetë pa
10 këmbë pa krye pa -- edhe ma se e kam hupë krejt. Miqtë.

11 PY. Na vjen shumë keq për këtë, dëshmitar. Në qoftë se të
12 kujtohet, në cilin fshat a qytet i gjete familjen edhe miqtë,
13 në qoftë se mundesh?

14 Z. DE MINICIS: [Pa përkthim]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos -
16 - një sekondë, do e ndërprisja unë.

17 Z. Dëshmitar, mos ke nevojë për një pushim?

18 DËSHMITARI: Jo, jo. Jo.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Avokat, kjo pyetje a lidhet gjë drejtpërdrejt, ose më saktë a
21 është nevoja që ta trajtojmë tani?

22 Z. AOIINI: [Përkthim] Jo, mund ta lëmë. Thjesht po
23 përpiqemi të kuptojmë periudhën kohore kur ka ndodhur. Kjo
24 ishte që ta lidhim me një referencë tjetër që kemi ne, që të
25 kuptojmë tamam periudhën kohore dhe të bëjmë ne një

1 përllogaritje.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
3 këmbëngul në qoftë se doni të kuptoni periudhën kohore, ta
4 formuloni pyetjen ndryshe, por mos këmbëngulni për këtë
5 ngjarje.

6 Z. AOUIINI: [Përkthim]

7 PY. Z. Dëshmitar, pothuajse mbaruam. A ju kujtohet në cilën
8 periudhë të vitit, ose në cilin muaj të vitit e gjete familjen
9 dhe u bashkove me ta?

10 PË. Nuk e di muajin, por këta janë kanë në Qerret të Kavajës,
11 e kur kanë ardhë i kam gjetë se s'e kam ditë ku janë. Në
12 Shqipëri, në Kavajë. Gjysmën e miqtë janë kanë të vramë,
13 gjysmën kanë pështu.

14 Z. AOUIINI: [Përkthim] Nëse më lejoni një çast të
15 konsult... [Mikrofoni çaktivizuar]

16 PY. Kam dhe një pyetje, z. Dëshmitar. Na treguat rrugën që
17 kishit ndjekur, grupin, numrin që kishte grupi, përbërja. Kam
18 një pyetje tani. A ka qenë ndonjë person me emrin Pjetër Shala
19 anëtar i grupeve që kanë udhëtuar bashkë me ju, janë stërvitur
20 me ju, kanë marrë pjesë në ndonjë veprimtari, edhe në momentin
21 kur grupi mori emrin Brigada 128?

22 PË. Jo, jo. Nuk kam dëgju as nuk a pasë. Pjetër -- me emrin
23 Pjetër Shala s'ka pasë.

24 PY. Faleminderit.

25 PË. Faleminderit.

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit Gjykatës. Kaq pyetje
2 kishim ne.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit, Avokat. Në rregull. Përpara se të vazhdojmë, z.
5 Dëshmitar, më vjen shumë keq që na u desh të flisnim për diçka
6 aq delikate për ju në këtë sallë gjyqi, aq të ndjeshme për ju.

7 Unë po shoh orën, të shohim si do të vazhdojmë.

8 Prokuror, është radha juaj për të bërë pyetjet. Ua lë ju
9 në dorë, kemi dhe 40 minuta që do të thotë ose mund të filloni
10 direkt me pyetjet, ose bëjmë pushimin tani dhe të vazhdojmë
11 pas pushimit. Do flas edhe me Zyrën Administrative -- Njësinë
12 për Administrimin e Gjykatës, për të parë se si mund ta
13 organizojmë kohën. Por fillimisht më thoni ju si preferoni.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më mirë bëjmë pushimin tani se
15 mund të shohim dhe referencat në transkript për kundërpjetet
16 tona.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
18 atëherë. Ja të flasim pak me përkthyesit përmes Sekretares së
19 Gjykatës sa i takon planifikimit. Të presim një çast.

20 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
21 këshillohen]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Dëshmitar, do bëjmë pushim tani një orë e gjysmë, të uroj
24 drekë të mirë, drekë të mbarë. Asistentja do t'ju shoqërojë.
25 Pushoni pak, do të vazhdojmë pasdite me pyetjet nga Zyra e

1 Prokurorit të Specializuar, në rregull?

2 DËSHMITARI: Faleminderit.

3 [Dëshmitar përfundon dëshminë]

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Ndërkohë, pyes palët a kanë ndonjë pyetje a ndonjë gjë për të
6 sqaruar? Ndonjë parashtrim? Jo, me sa shoh. Mirë atëherë.

7 Atëherë, bëjmë pushimin e drekës, do komunikojmë me
8 Njësinë e Përkthyesve dhe Njësinë për Administrimin e
9 Gjykatës, dhe do ju informojmë se si do vazhdojë pasditja.
10 Mund të bëjmë -- mund t'jua them direkt pas pushimit, ose mund
11 t'ju çoj një email për t'ju treguar si do të jetë e organizuar
12 pasditja.

13 Në rregull, seanca ndërpritet tani.

14 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.21

15 --- Seanca rifillon në orën 13.58

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
17 se erdhët përsëri.

18 A jemi në përbëmjen e njëjtë?

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju,
21 z. Laws?

22 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk jemi në përbëmjen e njëjtë,
23 jam vetëm unë sot pasdite.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit. Do ta marr shënim.

1 Dhe ju jeni në përbëmjen e njëjtë, i nderuar Avokat.

2 Tani do të vazhdojmë me kundërpjetjet e Prokurorit, por
3 me sa kuptova Mbrojtja kishte një pyetje. Kujt t'ia jap
4 fjalën?

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Ju faleminderit, e nderuar
6 Gjykatëse.

7 Patëm mundësi që ta kontaktojmë z. Shala, morëm disa
8 udhëzime prej tij. Pamë ca informacione në lidhje me diçka që
9 doli gjatë dëshmisë së dëshmitarit sot në mëngjes. Në faqet
10 33, rreshti 11 dhe më pas. Është nofka Ujku, dhe personi që
11 mbante këtë nofkë. Dhe kërkojmë leje, të nderuar Gjykatës, që
12 përpara se të fillojnë kundërpjetjet e Prokurorit, të mund t'i
13 bëjmë dëshmitarit nja dy pyetje në lidhje me këtë aspekt
14 specifik. Pra, përpara se të fillojë Prokuroria me pyetjet e
15 veta nëse mund t'ia bëj dëshmitarit nja dy pyetje për këtë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 A lidhet kjo edhe me materialin e porsanxjerrë?

19 Z. AOUINI: [Përkthim] Po. Ne sa e morëm këtë informacion
20 e bëmë njoftim në lidhje me këtë, nuk kemi ndërmend që t'ia
21 paraqesim këtë dokument dëshmitarit. Ne thjesht duam t'i bëjmë
22 disa pyetje shtesë në lidhje me këtë dhe meqenëse nuk është
23 qëllimi jonë që të përdorim dokumentin, t'ia lexojmë
24 dëshmitarit si -- thjesht ta përdorim atë dokument si bazë për
25 t'i bërë pyetje dëshmitarit dhe për këtë do të kisha kërku që

1 ta bëjmë këtë pyetje në seancë private për hir të Mbrojtjes së
2 informacionit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit.

5 A keni ju diçka për të komentuar, z. Prokuror?

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju faleminderit, nuk kemi
7 kundërshtim që Mbrojtja të bëjë pyetjen në qoftë se është e
8 nevojshme, në qoftë se ky dokument lidhet me pyetjet që do t'i
9 bëhen dëshmitarit, atëherë nuk është problem. Në këtë dokument
10 porsa e morëm, është në gjuhën shqipe, dhe e rezervojmë të
11 drejtën që të bëjmë pyetje dhe në qoftë se na duhet pak
12 pushim, të marrim atë pushim për të hetu më tej përmbajtjen e
13 këtij dokumenti.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Përpara se t'ia jap fjalën Mbrojtësit të Viktimave,
17 përpara se të kalojmë në seancë private, propozoj që t'i
18 pyesim përkthyesit të përkthejnë këtë dokument që i është
19 shtuar listës së dokumenteve për prezantim, dhe këtë do ta
20 kisha bë përpara se ta thërras dëshmitarin në sallë. Kjo që të
21 dijmë të gjithë se për çfarë bëhet fjalë në atë dokument.
22 Pastaj mund ta nxjerrim, ta largojmë dokumentin prej ekranit
23 dhe ta sjellim dëshmitarin në sallë dhe të futemi në seancë
24 private. Unë do të kisha dashtë që të vazhdojmë kështu.

25 A keni ju diçka për të shtuar, z. Avokati Mbrojtës i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744
Faqe 65

1 Viktimave?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kam, e nderuar Gjykatëse.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

4 Sekretare, a mund të kalojmë në seancë private?

5 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në bazë të F744

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private,
7 të nderuar Gjykatës.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit.

10 Znj. Sekretare, a mund ta vendosni në ekran dokumentin që
11 i është shtuar listës së dokumenteve për prezantim?

12 I drejtohem Mbrojtjes, cilën pjesë të këtij dokumenti do
13 ta përdorni si bazë për të bërë pyetjet dhe, më konkretisht,
14 cila është lidhja, rëndësia, relevanca, që duhet të ketë
15 parasysh Prokurori, Mbrojtësi i Viktimave dhe Trupi Gjygues,
16 dhe do t'u kërkoj përkthyesve që ta përkthejnë pastaj atë
17 pjesë.

18 Z. AOUBINI: [Përkthim] Ju faleminderit.

19 Është shumë e thjeshtë. E shikoni emrin në këtë postim,
20 se ka një komandant Bujar Ukimeri, e ka pasë nofkën Ujku. Këtu
21 tregohet lidhja me Ramushin dhe thjesht duam ta pyesim
22 dëshmitarin në qoftë se e di këtë emër, dhe në qoftë se di
23 diçka, në qoftë se mund ta bëjë lidhjen me këtë person. Jo
24 vetëm që mbiemri, një pjesë e mbiemrit, e përmban emrin Uki,
25 por ne kemi informacion që ky person edhe e ka pasë nofkën

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744
Faqe 66

1 Uki. Thjesht duam që t'i bëjmë dëshmitarit pyetjen në qoftë se
2 ka informacion në lidhje me këtë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë
4 e kam të qartë. Pyetja ime konkretisht ishte, cila pjesë e
5 këtij postimi në Instagram -- edhe pse m'u tha që është
6 Facebook, cila pjesë e këtij postimi në Instagram duhet të
7 përkthehet? Sepse dua që të më përkthehet ajo pjesë që ju
8 thoni është relevante.

9 Z. AOUINI: [Përkthim] Është postim prej Ramush Haradinajt
10 KS, domethënë teksti që është afër fotografisë duhet të
11 përkthehet tërësisht.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
13 rregull. Atëherë bëhet fjalë për 10 rreshta.

14 Pyetja ime për përkthyesit është, a mund ju lutem që të
15 na e përktheni tekstin -- që është afër fotografisë, në të
16 djathtë të fotografisë, dhjetë rreshtat. Përfundon me fjalën
17 Kelmendi? Faleminderit.

18 PËRKTHYESI: "Batalioni i parë sulmues i zonës operative
19 të Dukagjinit kreu detyrën me profesionalizëm e trimëri siç
20 kisha nderin t'i kem përkrah gjatë luftës çlirimtare. Sot u
21 bashkova me ta dhe komandantin Bujar Ukimeraj. Evokuam
22 kujtime, nderuam ata që ranë në krye të detyrës, në mënyrë që
23 shqiptarët të kenë liri. Heronjtë Fadil Nimani, udhëheqës i
24 batalionit, Jusuf Kelmendi dhe Ahmet Gjokolli."

25 Kaq shifet në tekst.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744
Faqe 67

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Mbrojtës, ndoshta gjithë e kanë të qartë përveç meje. Po
4 ku e shikoni emrin Ujku këtu?

5 Z. AOUBINI: [Përkthim] Sipas informacionit që kemi, ju
6 thashë që e kemi kontaktuar z. Shala personalisht dhe kemi
7 bazë për këtë informacion se ky person, Bujar Ukimeri ose
8 Ukimeraj, ka pasë nofkën Uki ose Ujku, dhe meqenëse dëshmitari
9 bëni lidhjen me njerëzit e Ramush Haradinajt.

10 Ato që e thashë mbiemrin është një pjesë e mbiemrit,
11 është Uki, Ukimeraj. Uki është një version tjetër i fjalës
12 Ujku, ose Vuk në serbisht. Domethënë kemi dëgjuar variante të
13 ndryshme të fjalës Ujku.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit për sqarimin.

16 Z. Prokuror.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do të përgjigjem shkurtimisht.
18 Një vërejtje e përgjithshme.

19 Ne themi që provat në këtë çështje tregojnë se z. Shala
20 ka qenë në zonën e Dukagjinit, por kjo ka qenë në vitin 1998.
21 Kemi prova shkresore si dhe deklaratat nga dëshmitarë në lidhje
22 me këtë aspekt. Kemi edhe prova që dëshmitari në 1998 ishte në
23 Gjermani, jo në Kosovë.

24 Kështu që nuk e shoh unë relevancën e kësaj pyetje,
25 domethënë, nuk është çështja t'i bëhet apo mos t'i bëhet

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744
Faqe 68

1 pyetja dëshmitarit. Thjesht mendojmë që duhet të vendoset një
2 herë një bazë, një themel, për përgjigjen e dëshmitarit. Të
3 pyetet në qoftë se a e ka njohë dikë nga zona e Dukagjinit në
4 atë kohë, sepse ai kishte dëgju për një komandant Ujku me
5 Haradinajn, e kështu me radhë. Domethënë kërkoj që Mbrojtja të
6 vendosë bazën, themelin për pyetjen e vet përpara se të bëhet
7 pyetje, në mënyrë që t'i shmangemi spekulimeve dhe
8 hamendësimeve.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit, z. Prokuror.

11 Ju, z. Mbrojtës, e keni fjalën.

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Ju faleminderit. Nuk e kemi ndër
13 mend aspak që të spekulojmë ose të nxisim dikënd tjetër të
14 spekulojë. Baza për pyetjen është shumë e thjeshtë. Dëshmitari
15 e di këtë emër.

16 E dyta, a e ka ndëgju këtë emër? Po, e ka ndëgju nga
17 burime të ndryshme përshirë nga programet televizive. Dhe
18 shumica e këtyne nofkave me të cilat jemi marrë gjatë gjykimit
19 kanë ardhë nga njerëz që i kishin ndigju apo të cilët ishin me
20 të ndëgjume. Thjesht duam ta pyesim në qoftë se ka ndonjë
21 person me nofkën Ujku, ndonjë person tjetër për të cilin ai
22 kishte dëgjuar.

23 Ai tha një person tjetër që edhe mund të mos jetë ndonjë
24 person tjetër. Thjesht kërkojmë nga ky zotni që të
25 identifikojë në qoftë se kishte një person tjetër me këtë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744
Faqe 69

1 nofkë konkrete ose jo. Në qoftë se thotë po, atëherë do t'i
2 bëjmë pyetje shtesë. Në qoftë se thotë jo, atëherë do ta lëmë
3 aty. Faleminderit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
5 Prokuror, ju gjatë kundërpvetjeve mund të bëni pyetje të tjera
6 në qoftë se e shihni të nevojshme që ta hetoni me tej këtë
7 aspekt.

8 Përpara se të vazhdojmë, znj. Sekretare, ju e vendosët
9 dokumentin në ekran, numri i provës, numri ERN i këtij
10 dokumenti, cili është? A mund të na e thoni me zë, ju lutem?

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Numri ERN është
12 DPS01569 deri DPS01570.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit, Sekretare.

15 A keni ju diçka për të shtu, Mbrojtësi i Viktimave?

16 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kam.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jemi
18 në seancë private. Tani do të kthehem përsëri në seancë
19 publike dhe do ta sjellim dëshmitarin në sallë.

20 Jo, duhet të hiqet dokumenti prej ekranit.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund të shtoj diçka, ju
22 lutem? Ndoshta do të ishte mirë që këtë pjesë ta bëjmë me
23 dëshmitarin në seancë private. Sepse postimi që e pamë është
24 postim publik, dhe ndoshta nuk ka nevojë të jemi në seancë
25 private.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744
Faqe 70

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Mbrojtës, a mund të na e sqaroni se pse duhet ta bëjmë këtë
3 pjesë në seancë private?

4 Z. AOUBINI: [Përkthim] Është e vërtetë që dokumenti është
5 publik, por çështja që trajtohet është delikate. Ne -- emrat,
6 lidhjet janë pak aspekte delikate dhe dua që t'i jepet
7 dëshmitarit mundësia të sqarojë në qoftë se ka nevojë. Kjo
8 është arsyeja për seancë private.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Prokuror?

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] ... kundërshtoj.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
13 parim, kjo duhet të bëhet në seancë publike sepse nuk është
14 fjala këtu për masa mbrojtëse. Nuk ka masa mbrojtëse ky
15 dëshmitar. Ajo që mund të bëjmë është të fillojmë në seancë
16 publike, por në qoftë se dëshmitari tregon hezitim atëherë do
17 të shohim si do të vazhdojmë. Sigurisht që nëse do të kishim
18 masa mbrojtëse, do të kishim kalu në seancë private. Por nuk e
19 shoh këtë të nevojshme.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më falni, transkripti e ka
21 regjistru përgjigjen time si "kundërshtoj", "kundërshtim", kur
22 unë në fakt thashë që "nuk kundërshtoj", "nuk kam
23 kundërshtim".

24 [Anëtarët e Trupit Gjykes këshillohen]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744
Faqe 71

1 Preferoj, parapëlqej, që ta fillojmë në seancë publike këtë
2 sepse nuk kam ndonjë arsye të vlefshme që të mos ta bëjmë këtë
3 në seancë publike. Nëse kjo do të shkaktojë ndonjë problem për
4 dëshmitarin, gjatë dëshmisë në lidhje me këtë, atëherë mund
5 edhe të shofim më pas si do të vazhdojmë.

6 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
8 Sekretare, ju lutem na ktheni në seancë publike.

9 [~~Seancë e hapur~~]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit.

13 Tani do të vazhdojmë me pyetjet e Mbrojtjes për këtë
14 dëshmitar. Znj. Sekretare, sillni dëshmitari në sallë, ju
15 lutem.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
18 se erdhët, dëshmitar.

19 DËSHMITARI: Faleminderit.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

21 Shala, a mund ta ndigjojsh zanin e dëshmitarit ose përkthimin?

22 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Po, e ndëgjoj shumë
23 mirë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Dëshmitar, do të vazhdojmë me pyetjet për ju. Përpara se
2 të fillojmë me pyetjet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar,
3 Mbrojtësi ka edhe nja dy pyetje. Unë do t'ia jap fjalën
4 Mbrojtësit për të t'i ba këto pyetje ty.

5 Avokat, fjala është për ju.

6 Z. AOIINI: [Përkthim] Faleminderit.

7 PY. Mirëdita z. Dervishaj. Unë kam një pyetje për një person.
8 Do ta bëj pyetjen dhe, të lutem, përqendrohu te pyetja dhe
9 përgjigju me "po" ose "jo". Varësisht nga përgjigjja jote unë
10 mandej do të bëj pyetje shtesë.

11 Z. Dëshmitar, e njeh ndonjë person me emrin Bujar
12 Ukimeri.

13 PË. Po, i Prizrenit është.

14 PY. Z. Dëshmitar, i tash do të bëj disa pyetje. Në qoftë se
15 nuk e ke të lehtë të hysh në hollësi, na trego, por do ta
16 bëjmë kështu, hap mbas hapi.

17 Pyetja im e parë është kjo: Ky person, a e din, a ka qenë
18 ushtar gjatë luftës?

19 PË. E di që ka qenë. Ma tepër s'di për të.

20 PY. A e din se në cilën zonë ka qenë ushtar, ka shërby?

21 PË. Jo, jo. Nuk e di.

22 PY. A e din në qoftë se ka pasë ndonjë nofkë, ndonjë
23 pseudonim ky person?

24 PË. Nuk kam ndëgjju. Nuk -- s'e njof mirë.

25 PY. Faleminderit, dëshmitar.

1

2 Z. AOUINI: [Përkthim] Kaq ishin pyetjet tona, znj.

3 Gjykatëse.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit.

6 Dëshmitar, tani do të vazhdojmë me pyetjet e Prokurorisë.

7 Përpara se të fillojmë me ato pyetje, ne si Trup Gjykses
8 do të japim një urdhër gojor në lidhje me kërkesën e
9 Prokurorisë për përdorimin e katër materialeve të porsa
10 nxjerra me këtë dëshmitar. Tre janë postime në Facebook dhe
11 një është një dokument tjetër.

12 Kërkesa është bërë me email, më 23 shtator, e premte, në
13 orën 14.07. Materialet u nxorën në të njëjtën ditë, është
14 paketa e nxjerrjes 165, dhe ato dokumente u shtuan në listën e
15 dokumenteve për prezantim me këtë dëshmitar. Nuk pat
16 kundërshtime as nga Mbrojtja as nga Mbrojtësi i Viktimave në
17 lidhje me përdorimin e këtyre dokumenteve.

18 Trupi Gjykses lejon Prokurorinë që t'i përdorë këto
19 dokumente me dëshmitarin, sepse janë një numër i kufizuar
20 dokumentesh. Palët kanë pasë mundësinë që t'i shikojnë se
21 çfarë përmbajnë ato.

22 Tani do t'ia jap ZPS-së, Prokurorit, pra fjalën për të bërë
23 pyetjet.

24 Mbrojtja përdori një orë e 45 minuta, për pyetjet e veta.

25 Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis:

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

2 PY. Mirëdita z. Dervishaj. Unë jam Filippo De Minicis dhe
3 përfaqësoj Zyrën e Prokurorisë në këtë gjykim.

4 Sot i shpjegutë Trupit Gjykses se si, mbasi mbërritët në
5 Kukës, u mobilizutë në Repartin 1. Është faqja 17 dhe 18 e
6 transkriptit të përkohshëm të ditës së sotshme. A është kjo e
7 saktë?

8 PË. Po.

9 PY. Gjithashtu na tregove se shkove te Reparti 2 herë për të
10 marrë injeksione kundër dhimbjeve në shpinë, a është kjo e
11 saktë

12 PË. E saktë.

13 PY. A mund të na thush se cila ishte distanca, domethënë,
14 midis Repartit 1 edhe Repartit 2? Sa larg ishin njoni prej
15 tjetrit këto repartet?

16 PË. Ajror nuk janë fort larg, por kështu me rrugë janë larg
17 se të ndahet njani në të majtë njani në të djathtë.

18 PY. Domethënë, po qe se e bën në këmbë këtë rrugë, sa kohë të
19 merr?

20 PË. Gjysë ore.

21 PY. Sot - dhe besoj se është në faqen 33 të transkriptit të
22 përkohshëm, jopërfundimtar - ju thatë se kishit ndigju për
23 Pjetër Shalën vetëm në televizor. A ju kam kuptu drejt?

24 PË. Po.

25 PY. A të kujtohet kur ke ndigju për z. Shala në televizor?

1 PË. Gjatë gjykimit të juaj. Nuk e di datën, veç gjatë gjykimit
2 kam dëgju.

3 PY. Domethënë, në qoftë se të kam kuptu drejt, kjo është për
4 herë të parë kur ke ndigju për të? A është kjo e saktë?

5 PË. E saktë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
7 Dëshmitar, e keni fjalën për këtë gjykim ku jemi tash, a të
8 kam kuptu drejt?

9 DËSHMITARI: Po, nëpërmjet televizionit, në këtë gjykim.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, iu përgjigje Mbrojtjes dhe të tjerëve të
14 pranishëm në sallën e gjyqit se e ke njoftë një person me
15 emrin Naser Koçinaj, i cili ka punu te depoja sepse ka qenë
16 përgjegjës për t'ua dhanë teshat dhe ushqimin ushtarëve. Kjo
17 është në faqen 36 dhe 37 të transkriptit, a është kjo e saktë?

18 PË. Po, e saktë është.

19 PY. Kur për herë të parë e ke taku Naser Koçinajn, domethënë
20 për herë të parë kur e ke taku këtë person?

21 PË. Gjatë luftës nuk e kam taku, por kam ndigju për të kur
22 mirrshim teshat, që mirrshim me hangër. Se unë vetë
23 personalisht s'e kam taku, se s'kam pasë detyrë.

24 PY. Po ky, z. Koçinaj a ka qenë edhe vetë anëtar i Ushtrisë
25 Çlirimtare të Kosovës?

- 1 PË. Nuk e di, në magazinë veç e di që ka punu, nuk e di. Ma
2 ani nuk e di.
- 3 PY. A e ke taku ti z. Koçinaj ndonjëherë personalisht?
- 4 PË. Po, e kam taku pas luftës, para luftës, se i kemi
5 fshatnat afër. Ama gjatë luftës, po të tregoj qysh jemi taku.
- 6 PY. Po kur ka qenë hera e parë në jetën tande që e ke njoftun
7 këtë z. Koçinaj, Kocinaj, Kuçinaj? A e ke njoftë para lufte?
- 8 PË. Kur i kam pasë 12 vjet.
- 9 PY. A e ke pa ndonjëherë gjatë luftës?
- 10 PË. Jo, nuk jemi taku.
- 11 PY. Na tregove që z. Koçinaj e njef prej moshës 12 vjeçare. A
12 keni mbetë në kontakt, a keni mbajtur kontakt mbas luftës, ti
13 edhe z. Koçinaj?
- 14 PË. Po ne jemi të përzimë familjarisht. Se unë motrën e kam
15 të martume te ata.
- 16 PY. Atëherë a e keni mik, shok, z. Koçinaj?
- 17 PË. Mik edhe shok.
- 18 PY. Kur për herë të fundit e keni pa z. Koçinaj?
- 19 PË. Para një jave. Para gjashtë, shtatë ditë.
- 20 PY. Dhe kur e pa atëherë për herë të fundit a i tregove që ke
21 me ardhë me dhanë dëshmi në këtë gjykim?
- 22 PË. Po.
- 23 PY. Dhe çfarë komentoit ai kur i tregove që ke me ardhë, në
24 qoftë se ka bo ndonjë koment?
- 25 PË. Jo, asgjë. Veç rrugë të mbarë, asgjë tjetër.

1 PY. Po a e diskututë në ndonjë mënyrë, a i diskututë në
2 ndonjë mënyrë pyetjet e mundshme që mund t'ju bohen në qoftë
3 se vini për të dhënë dëshmi këtu?

4 PË. Jo, jo. Jo. Q'ato që i dimë, q'ato -- nuk, s'kemi --
5 s'kemi bisedu asgjë.

6 Z. DE MINICIS: [Mikrofoni çaktivizuar]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Vazhdoni.

9 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

11 PY. Z. Dervishaj, përpara se të vijshit këtu për të dhënë
12 dëshminë na tregove se informutë z. Koçinaj se do të vinit për
13 të dhënë dëshminë. A ju ke tregu edhe dikujt tjetër që do të
14 vish për të dhanë dëshminë në Hagë, a i ke tregu edhe
15 tjetërkujt?

16 PË. Familjes time. Familjes së ngushtë.

17 PY. Të gjithëve në familje -- më falni. Vetëm familjes?

18 PË. Veç familjes.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Një çast, të nderuar Gjykatës.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Nuk ka
21 përkthim]

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

23 PY. Ndonjë person tjetër veç familjes, apo në komunitetin ku
24 jeton, a e kanë marrë vesh që do vije këtu në Hagë për të
25 dhënë dëshmi?

1 PË. Veç taksisti që më ka pru, tjetërkush jo.

2 PY. Z. Faruk Hoxhaj, pjesëtar i familjes suaj është?

3 PË. Jo, jo.

4 PY. Të pyeta për këtë se z. Hoxhaj ka bërë një postim në
5 Facebook para se të vije ti këtu. Dhe ka bërë një postim për
6 dëshminë që do jepje ti në Hagë.

7 PË. Nuk ka mundësi. Q'atë ditë veç, kur jam nis tek ne,
8 ndoshta ka marrë vesh. Se unë për vete nuk kam Facebook.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
10 shfaqim në ekran një dokument që ka numrin -- më falni, është
11 një postim në Facebook, lidhet drejtpërdrejt me këtë që po
12 diskutojmë tani.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
14 shoh nga Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave çfarë mendojnë në
15 lidhje me këtë. Por ndërkohë na jepni numrin ta kuptojmë se
16 për çfarë bëhet fjalë konkretisht.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në rregull. Postimi në Facebook
18 është SPOE00341624-00341628. Përkthimi në anglishte është
19 00341614 [sipas përkthimit] deri në 00341624-ET.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do i
21 lutesha Asistentes -- të fikë pak ekranin e dëshmitarit, ta
22 shohim një herë ne dokumentin fillimisht. Besoj se të gjithë e
23 dimë për cilin dokument bëhet fjalë, por për të qenë të sigurt
24 është mirë që ta verifikojmë.

25 Asistente, na konfirmoni që e fikët ekranin? Në rregull.

1 Përveç Mbrojtjes, a ka ndonjë kundërshtim tjetër lidhur
2 me përdorimin e këtij dokumenti? Dhe nëse gjykoni nëse
3 dëshmitari duhet të shoqërohet jashtë sallës së gjyqit, më
4 thoni që ta bëj këtë gjë.

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë mund të
6 flas në gjuhë të koduar, megjithatë në qoftë se do flasim me
7 hollësi, mund ta nxjerrim dëshmitarin jashtë. Parimisht nuk
8 kemi ndonjë kundërshtim, por nga sa kuptojmë ne deri tani
9 burimi i këtij informacioni nuk është dëshmitari ynë. Duhet të
10 jemi të kujdesshëm.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
12 po, e dimë këtë, jemi në dijeni të kësaj, të gjithë. Të paktën
13 ne këtu në Panel, Trup Gjykses, jemi të qartë.

14 Trup Gjykses [sipas përkthimit] keni ndonjë kundërshtim?

15 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kam asnjë kundërshtim.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Atëherë, Asistente, ndizeni sërish ekranin e kompjuterit.

18 Atëherë, z. Prokuror, keni lejen nga ana e Trupit Gjykses
19 që të shfaqet dokumenti në ekran.

20 I lutem Sekretares së Gjykatës të vendosë në ekran
21 dokumentin që ta shohin të gjithë.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mund të vendosni postimin
23 origjinal, ta zmadhoni më shumë. Përkthimi është përkthimi që
24 ka nxjerrë vetë Facebook poshtë postimit të shqipes. Nuk është
25 nevoja që t'i shfaqim të dyja, mjafton të shfaqni vetëm një.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
2 shihja anglishten, por ju thoni që është në anglisht poshtë
3 tekstit origjinal --

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirë, thjesht duam të na
5 konfirmojë nëse e njeh personin që është --

6 PY. Atëherë, po e bëjmë pyetjen. Z. Dëshmitar, e lexoni dot
7 emrin e autorit të këtij postimi në Facebook?

8 PË. Po.

9 PY. Si e ka emrin?

10 PË. Faruk Hoxha.

11 PY. E keni shok?

12 PË. Bashkë kemi qenë në luftë.

13 PY. Ju thoni që nuk e keni informuar që do të vini për të
14 dhënë dëshmi në Hagë?

15 PË. A mundeni me ma vërtetu se në cilën datë është? Kjo është
16 një ditë përpara, kur jam nisë te kënejna. Nji ditë është
17 përpara, më 27.

18 PY. Po, në 27, fiks. Tamam.

19 PË. Në 27 e kanë marrë vesh krejt.

20 PY. Këtu të paktën çfarë thuhet, lexojmë kështu:

21 "Sonte, shoku Bedri Dervishaj udhëton për në Gjykatën
22 Speciale të Hagës. Ne shpresojmë me bindje të plotë në
23 pafajësinë tande, Bedri. Të kthehesh ma i fortë dhe
24 faqebardhë. Lufta e UÇK-së është themeli i lirisë dhe e
25 ardhmja e Kosovës. Respekt, shok, si gjithmonë i pathyer."

1 Unë një pyetje kam për këtë. Ju mendoni se duke ardhur
2 këtu si dëshmitar, pritet që ju të jepni dëshmi të caktuar?
3 Është pritur që juve të jepni një dëshmi të caktuar si
4 dëshmitar këtu?

5 PË. A po e sheh, ky nuk e ka kuptu dhe për çka kam ardhë. A
6 si dëshmitar, a si i akuzumë. Se nuk e din edhe për çfarë
7 arsye kam ardhë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
9 ndryshe qe pyetja, z. Dëshmitar. Ju mendoni që ka pasur
10 pritshmëri ndaj jush që -- janë krijuar pritshmëri ndaj jush?

11 DËSHMITARI: Nuk mund t'i ndali njerëzit ça shkrujnë. E
12 drejtë e tyne është.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

14 PY. Shumë e drejtë. Por po mendojmë, mendoni ju se në
15 bashkësinë ku jetoni ju, duke ardhur ju këtu si dëshmitar, u
16 krijua ndonjë farë pritshmërie për ju që ju, domethënë, mund
17 të silleni -- presin që ju të silleni në një mënyrë të caktuar
18 këtu?

19 Z. AOUINI: [Përkthim] E kundërshtoj.

20 DËSHMITARI: Jo ...

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Mikrofoni
22 çaktivizuar]

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Me lejen tuaj, të nderuar
24 Gjykatës. Mund të them që ta hiqnim këtë postim, por dua të
25 nxjerr një postim të ngjashëm për dëshmitarin dhe mbarojmë me

1 këtë pistë pyetjesh.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Prokuror, mund të vazhdoni. Por unë duhet të them që unë s'e
4 kisha mikrofonin e ndezur qëparë dhe thashë "E rrëzoj
5 kundërshtimin e Mbrojtjes".

6 Dhe kjo nuk reflektua, sepse nuk është reflektuar
7 përgjigja në transkript. Këtë po e them për procesverbal.
8 Vazhdoni.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mund të shfaqim në ekran një
10 fotografi që besoj është e datës 28 shtator ose 27. Është
11 materiali numër 12 në listën time të provave materiale, jo në
12 listën e prezantimeve. Do sigurohem që të përkojnë herën
13 tjetër. Është numër SPOE00341629 deri në 00341632.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Përpara se t'ia tregoni dëshmitarit, do të doja të dëgjoja në
16 qoftë se ka kundërshtime nga Mbrojtja apo Mbrojtësi i
17 Viktimave.

18 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Sekretare, transmetojeni, ose vendoseni më saktë në ekran.
21 Ndërkohë i lutem Asistentes të fikë ekranin e kompjuterit të
22 dëshmitarit.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

24 PY. Z. Dëshmitar, e lexon dot emrin --

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Prisni një çast, të shohim a ka kundërshtime. Kjo është një
2 mënyrë e re pune, të mos kemi kaq shumë diskutime gjyqësore
3 paraprake dhe në sallën e gjyqit.

4 Avokat.

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Po. Parimisht nuk kemi
6 kundërshtime, por ne s'patëm mundësi më përpara kur kishim --
7 ne deshëm ta kundërshtonim përdorimi e këtij dokumenti sepse
8 me sa kuptojmë ne, kolegët tanë po përdorim disa mesazhe
9 mbështetëse që janë bërë nga shoqëria e tij dhe e pyesin a ka
10 pasur pritshmëri komuniteti juaj. Nuk ka lidhje, e
11 kundërshtojmë. Siç tha dëshmitari, nuk është kuptuar qartë për
12 çfarë ka ardhë dëshmitari këtu. Por flasim nga shoqëria, te
13 pritshmëritë e komunitetit. Nga disa shokë të ngushtë, tani po
14 flasim për pritshmëri komuniteti. Ku është lidhja këtu?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Doni
16 t'u përgjigjeni, Prokuror?

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Unë me një pyetje të thjeshtë e
18 thashë, komuniteti i ngushtë, kur themi komuniteti i ngushtë e
19 kam fjalën dhe për shokë dhe për familjen e ngushtë. A kanë
20 pritshmëri prej jush?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Avokat, unë nuk e shoh -- unë mendoj që kjo është pyetje
23 legjitime për dëshminë që po jepet këtu. Dhe nuk mendoj se
24 Prokurori po i ushtron trysni dëshmitarit.

25 Kështu që vazhdoni.

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

2 PË. Faleminderit. Pothuajse mbaruam. Më falni shqiptimin,
3 nejse, në shqip Hamit Bytyqi më duket se është emri. E keni të
4 afërm apo e keni -- keni thjesht njohje me të?

5 PY. Thjesht njohje. Kurrëgjë, asgjë tjetër.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

7 Prokuror, nëse duam ta përdorim këtë dokument fillimisht duhet
8 të pyes edhe Mbrojtësin e Viktimave a ka ndonjë pikëpamje apo
9 ndonjë kundërshtim, në qoftë se ka, kuptohet.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Jo nuk kam asnjë parashtrim për të
11 bërë në lidhje me këtë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
13 kërkoi ndjesë që ju harrova.

14 Asistente, tani mund të ndizni -- [Mikrofoni
15 çaktivizuar].

16 Prokuror, besoj tani mund të vijoni.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

18 PY. Z. Dervishaj, e lexoni në shqip postimin? Është në të
19 djathtë të ekranit, lart. Në qoftë se do, e zmadhojmë dhe më
20 shumë.

21 PË. Po, e lexova.

22 PY. Kjo është arsyeja pse ju pyeta unë a ka pritshmëri për
23 ju, se mjaft të bëjmë një kërkim të shpejtë në Facebook, ditën
24 që ke udhëtuar për në Hagë, gjetëm dy persona që shprehin të
25 njëjtin përkrahje, dhe Hamit Bytyqi thotë:

1 "Qoftë faqebardhë, çlirimtar ashtu siç ke qenë në luftë,
2 ashtu në liri, u kthefsh me kokën lart prej Hage, Bedri
3 Dervishaj."

4 Dhe unë po ju pyet dhe një herë a ka pasur pritshmëri në
5 familjen tuaj, shokë tuaj të ngushtë, por edhe të njohurit.
6 Pra, a kanë pasur këta pritshmëri që ti këtu të sillesh në një
7 mënyrë të caktuar si dëshmitar?

8 PË. Po pritshmëri nuk ka pasë, por unë nuk e di. Unë nuk mund
9 me ndalë gjindjen ça shkrujnë këto. S'e shoh të arsyeshme.
10 Tash unë s' -- kush s'e ka ditë më 27, e kanë marrë vesh që
11 vij tek ne. Më 27 kanë shkrujtë, tash, unë s'muj me i ndalë në
12 Facebook. Unë Facebook temin s'kam. Tash unë s'mund të hi në
13 Facebook me i ndalë çka shkrujnë gjindja.

14 PY. Absolutisht, ashtu. As nuk po themi që duhet ta bësh. Nuk
15 e kishim këtu fjalën.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne nuk
17 kemi më pyetje për këtë dëshmitar.

18 PY. Z. Dervishaj, ju urojmë rrugë të mbarë për në shtëpi.

19 PË. Faleminderit.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit. Faleminderit, z. Prokuror.

22 Mbrojtësi i Viktimave, ju a keni pyetje për dëshmitarin?

23 Z. LAWS: [Përkthim] Jo nuk kam pyetje.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
25 jemi tek pjesa e pyetjeve shtesë. Avokat, keni pyetje për

1 dëshmitarin?

2 Z. AOUINI: [Përkthim] Ja më jepni një çast të
3 konsultohem.

4 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Nuk kemi më pyetje.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit.

8 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
10 Dëshmitar, ju kanë drejtuar pyetje sot Avokatët Mbrojtës, Zyra
11 e Prokurorit të Specializuar. Duroni dhe pak. Një nga
12 Gjykatësit, Gjykatësi Bitti, që është në të majtën time, ka
13 disa pyetje për ju. Edhe është te pjesa e fundit për dëshminë
14 për ju. Faleminderit.

15 Fjala është për ju.

16 Pyetje nga Trupi Gjykses:

17 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Z. Dëshmitar, sot paradite
18 folët për Ilir Rakajn, të cilin e keni parë në Repartin 2
19 thatë, dhe ju bëri një injeksion. Ka qenë në faqen 29 të
20 transkriptit -- kur shkove tek -- Reparti 2, e dije ti që
21 ishte atje ai, e ke ditë më parë?

22 PË. Jo, nuk e kam ditë që është ai aty. Unë veç kam lypë
23 ndihmë prej mjekëve. Rastësisht se e kam pa atë aty. Me atë
24 njifemi se jemi gjeneratë.

25 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] A ju tha ai që punonte dhe

1 dikush tjetër me atë? Flasim, e kam fjalën, ndonjë doktor

2 tjetër, apo ndonjë motër, a punonte njeri tjetër me të?

3 PË. Unë s'e di, veç kur më ka pa ai mue, erdh edhe ai ma dha
4 një injeksi, tha ha [fonetikusht] një injeksi për dhimbjet se
5 e dike të dhimbtën teme, edhe dy herë kam shku masanej tek
6 ai. I kam marrë -- çdo muaj e kam marrë nga një prej tij.

7 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Ato dy herët që shkove atje,
8 ishte vetëm ai, kështu?

9 PË. Herën e parë rastësisht, të dytën e kërkova vetë atë.

10 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Dhe ai ishte i
11 vetmi person i pranishëm kur të bëri injeksionin, s'kishte
12 njeri tjetër?

13 PË. Jo, jo. Erdh vetë. Nuk e di a ka pasë të tjerë, ai vetë
14 erdh. Se veç një injeksion për dhimbtë, tjetër plagë s'kam
15 pasë.

16 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit.

17 Sot paradite, po në faqen 29 të transkriptit the që ishte
18 me rroba ushtarake. A të kujtohet, beretë kishte? E mban mend?
19 Kapelë, beretë?

20 PË. Nuk më kujtohet. Muj me gabu, nuk më kujtohet.

21 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

22 Pyetja e fundit, më shumë pyetje sqaruese është, lidhur
23 me diçka që thatë sot paradite që nuk e kam kuptuar tamam.

24 Para se të bënim pushimin, në faqen 36, rreshti 18 i
25 transkriptit, të pyetën nëse të kujtohej një person me emrin

1 Halil Gashi. Dhe u përgjigje, "Nuk më kujtohet". Por pas
2 pushimit në faqen 40, rreshti 21, the "Halil Gashi vdiq". Me
3 sa duket ka vdekur kur ishit në Burrel.

4 Këtu e kam paqartësinë, s'po e bëj dot lidhjen mes këtyre
5 dy gjërave që thatë. Se një herë thatë nuk më kujtohet, pastaj
6 keni thënë që vdiq.

7 A mund të na e shpjegoni këtë?

8 PË. Po, e vërtetë është si thashë ashtu, se më pyeti a është
9 -- a e njihje? Unë thashë nuk e njoh, masanej kur thanë
10 Burrel, në Burrel thashë është i vramë. Halil Gashi. Kur tha
11 kush është vra? Halili. Halilin e kam edhe atë mik shtëpie.
12 Shok jemi kanë edhe me atë.

13 E vërtetë është që thashë, nuk e njoh Halilin. Por,
14 "Halilin e vranë?" Po, por Halil Gashin nuk njoh.

15 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, e njihnit, por ju kujtua
16 vetëm se u përmend Burreli? Pra e njihnit, por ju kujtua prej
17 Burrelit?

18 PY. M'u kujtua kur tha rasti i Burrelit, atëherë m'u kujtua
19 Halil Gashi.

20 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar.
21 Nuk kam më pyetje.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit, Gjykatësi Bitti.

24 Z. Dëshmitar, përfunduar me dëshminë tuaj. Nuk kam më
25 pyetje prej palëve, Mbrojtësi i Viktimave dhe Trupi Gjykues.

1 Ju falënderojmë për dëshminë tuaj që besoj se do të na
2 ndihmojë që të zbulojmë të vërtetën. Edhe një herë,
3 faleminderit.

4 DËSHMITARI: Faleminderit edhe prej jush.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
6 rikujtoj që nuk duhet ta diskutoni dëshminë që keni dhënë këtu
7 në sallën e gjyqit, para Dhomave të Specializuara, me askënd.

8 DËSHMITARI: Unë kam dhanë as nuk kam kallëzu që -- por
9 kur kam ardhë tek ne ata normal që kanë marrë vesh krejt. Edhe
10 që po thotë ky që tha në Facebook, ai Facebook-i e ka më 27, e
11 tek ne, një ditë përpara, kur jam nisë. Përpara s'ka në
12 Facebook se s'e ka ditë kush.

13 Edhe atë e ka postu djali sefte, prej Sllovenisë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
15 Dëshmitar, faleminderit që e sqaruat këtë pjesë. Sidoqoftë, e
16 kam fjalën tani për dëshminë që keni dhënë sot në sallën e
17 gjyqit. Këtë dëshmi mos e diskutoni me askënd.

18 Tani do i kërkoj Asistentes që t'ju shoqërojë jashtë
19 sallës së gjyqit --

20 DËSHMITARI: Faleminderit, faleminderit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] --
22 dhe ju urojmë një pasdite të këndshme.

23 DËSHMITARI: Edhe prej jush, faleminderit.

24 [Dëshmitari largohet]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Mirë, për sot mbaruam. Mbaruam me dëshminë. Do vazhdojmë
3 nesër me dëshmitarin e radhës, Dëshmitarin numër 5. Në orën
4 9.30.

5 Lidhur me materialet që janë propozuar për pyetjet e
6 drejtpërdrejta dhe për kundërpvetjet, si rregull duhet t'i
7 japim kundërshtimet me shkrim. Sot pata nevojë për shumë
8 sqarime për postimet. Si rregull, thashë do t'i lexojmë të
9 përdoren dokumentet për pyetjet, në rast se nuk janë marrë
10 paraprakisht me shkrim kundërshtimet.

11 Mirë. Sa i takon datës 26 dhe 27 tetor, Avokat, me sa
12 kuptova unë ju jeni të lirë, por patët dhe një kërkesë për
13 sqarim. Nëse është nevoja të kalojmë në seancë private, por
14 nëse thoni jemi të lirë, s'ka nevojë të diskutojmë më tej.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jemi të lirë, nuk është nevoja ta
16 diskutojmë më tej.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
18 faleminderit.

19 Zyra e Prokurorit të Specializuar, ka ndonjë pyetje?

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Mbrojtësi i Viktimave?

23 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Avokati Mbrojtës?

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Nëse na lejoni pak
2 çaste të diskutojmë diçka administrative. Dua t'ju informoj
3 diçka sa i takon paraqitjeve të dëshmitarëve. Na është kërkuar
4 për ekspertët të koordinojmë me -- të koordinojmë
5 paraprakisht. Ne mund të bëjmë një propozim për ju, të nderuar
6 Gjykatës, se kur mund të jenë të disponueshëm dëshmitarët
7 ekspertë. Do të diskutojmë paraprakisht me Mbrojtësin e
8 Viktimave dhe sugjerojmë 24 nëntorin si datën për ekspertin e
9 viktimave. Ndërsa ne, nga ana jonë, propozojmë datën 30 nëntor
10 deri në 1 dhjetor, ose kur t'ju volisë në janar, sepse kjo i
11 jep mundësinë ekspertit tonë të lexojë dëshminë e ekspertit të
12 viktimave, në mënyrë që t'i kundërpërgjigjet.

13 Eksperti ynë në përgjithësi është i lirë, thjesht duhet
14 ta njoftojmë paraprakisht. Sidoqoftë, eksperti do të paraqitet
15 vetëm me videolidhje sepse duhet të kujdeset për fëmijët. Por,
16 është fleksibël, kështu që kur të dëshironi, ose në fund të
17 nëntorit, pra blloku i fundit që kemi për këtë vit, ose
18 bllokun e parë të vitit tjetër. Bllokun e dëshmive, pra. Këtë
19 po e them për qëllime planifikimi.

20 Kemi dhe një datë konkrete për Dëshmitarin Ekspert 3 që
21 konfirmoi se do të jetë i lirë më 27 nëntor, kështu që mund të
22 fillojmë me javën e dytë të dëshmive me të, pra përkatësisht
23 më 27 nëntor mund të fillojmë me bllokun e radhës të dëshmive.

24 Ky është informacion që kemi ne tani për momentin.
25 Sigurisht që në momentin që do të marrim materialet do të

1 bëjmë -- do të ndërmarrim hapat përkatës sa i takon njoftimit
2 dhe modifikimit të listës së dëshmitarëve, kemi diskutuar me
3 Zyrën Administrative për organizimin logjistik. Është duke u
4 trajtuar kjo pjesë tani. Krahas faktit që eksperti ekonomist
5 ende nuk është në listën e dëshmitarëve, megjithatë puna ka
6 filluar për ta shtuar në listë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ky
8 është një dëshmitar për të cilin ende nuk jemi njoftuar, z.
9 Avokat?

10 Z. AOUMINI: [Përkthim] Me kërkesën tuaj ju çuam biografinë
11 e ekspertit, të kuptoni cili është personi. Shumë shpejt
12 presim të marrim dhe raportin, sapo ta marrim do ta ndajmë me
13 ju. Por po ju thoja që ne po organizojmë me Zyrën
14 Administrative dëshminë, ndonëse dëshmitari nuk është
15 zyrtarisht në listën e dëshmitarëve, puna ka filluar për
16 dëshminë e tij.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
18 rregull. Faleminderit, e kuptova tani çfarë donit të thonit.

19 Në rregull. Në qoftë se kishit vetëm kaq për të thënë,
20 mund të përfundojmë për sot.

21 Do shihemi nesër në orën 9.30.

22 --- Seanca mbyllet në orën 15.04

23

24

25